

LIGJ
Nr. 91/2025

PËR RATIFIKIMIN E TRAKTATIT TË RIADIT PËR DISENJOT
DHE TË RREGULLOREVE SIPAS KËTIJ TRAKTATI,
BËRË NË RIAD, MË 22 NËNTOR 2024

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet Traktati i Riadit për Disenjot dhe të rregulloreve sipas këtij Traktati, bërë në Riad, më 22 nëntor 2024, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 18.12.2025.

Shpallur me dekretin nr. 3, datë 6.1.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.



E

DT/DC/26
ORIGJINALI: ANGLISHT
DATA: 25 NËNTOR 2024

Konferenca Diplomatike për Lidhjen dhe Miratimin e Traktatit për Disenjot (DT)
Riad, 11 deri 22 nëntor 2024

TRAKTATI I RIADIT PËR DISENJOT, RREGULLORET SIPAS TRAKTATIT TË RIADIT
PËR DISENJOT DHE REZOLUTA E KONFERENCËS DIPLOMATIKE PLOTËSUESE E
TRAKTATIT TË RIADIT PËR DISENJOT DHE RREGULLORET PËRKATËSE
Miratuar nga Konferenca Diplomatike, më 22 nëntor 2024

TRAKTATI I RIADIT PËR DISENJOT

DLT/DC/26
TRAKTATI I RIADIT PËR DISENJOT

LISTA E NENEVE

- Neni 1 – Shprehjet e shkurtuara
- Neni 2 – Parimet e përgjithshme
- Neni 3 – Aplikimet dhe disenjot industriale për të cilat zbatohet ky Traktat
- Neni 4 – Zbatimi
- Neni 5 – Përfaqësuesit; adresa për dorëzimin ose adresa për korrespondencën
- Neni 6 – Data e paraqitjes së aplikimit
- Neni 7 – Periudha e tolerancës për paraqitjen në rast të zbulimit
- Neni 8 – Kërkesa për paraqitjen e aplikimit në emër të krijuesit
- Neni 9 – Ndryshimi ose ndarja e aplikimit që përfshin më shumë se një diseno industriale
- Neni 10 – Publikimi i disenjos industriale
- Neni 11 – Sistemi elektronik për disenjon industriale
- Neni 12 – Komunikimet
- Neni 13 – Rinovimi
- Neni 14 – Lehtësim në respektim të afateve kohore
- Neni 15 – Rivendosja e të drejtave pas një konstatimi nga Zyra për Kujdes të Duhur ose pavullnetshmëri
- Neni 16 – Korrigjimi ose shtimi i kërkesës për prioritet; rivendosja e të drejtës së prioritetit
- Neni 17 – Kërkesë për regjistrimin e një licence ose interesi garancie
- Neni 18 – Kërkesë për ndryshim ose anulim të regjistrimit të një licence ose një interesi garancie
- Neni 19 – Efektet e mosregjistrimit të një licence
- Neni 20 – Treguesi i licencës
- Neni 21 – Kërkesa për regjistrimin e një ndryshimi në pronësi
- Neni 22 – Ndryshimet në emra ose adresa
- Neni 23 – Korrigjimi i një gabimi
- Neni 24 – Asistenca teknike dhe ngritja e kapaciteteve
- Neni 25 – Rregulloret
- Neni 26 – Asambleja
- Neni 27 – Byroja Ndërkombëtare
- Neni 28 – Rishikimi
- Neni 29 – Bërja palë e Traktatit
- Neni 30 – Hyrja në fuqi; data e hyrjes në fuqi e ratifikimit dhe aderimit
- Neni 31 – Rezervat
- Neni 32 – Prishja e marrëveshjes me Traktatin
- Neni 33 – Gjuhët e Traktatit, nënshkrimi
- Neni 34 – Depozitari

Neni 1 **Shprehje të shkurtuara**

Për qëllimet e këtij Traktati, përveç nëse përcaktohet ndryshe:

- i. “Palë Kontraktuese” nënkupton çdo shtet ose organizatë ndërqeveritare që është palë në këtë Traktat;
- ii. “Zyra” nënkupton agjencinë e një pale Kontraktuese të cilës i është besuar regjistrimi i disenjove;
- iii. “Regjistrim” nënkupton regjistrimin e një disenjoje industriale ose dhënien e një patente për një diseno industriale, nga një zyrë;
- iv. “Aplikim” nënkupton një aplikim për regjistrim;

v. “Ligji në fuqi” nënkupton, kur pala kontraktuese është një shtet, ligjin e atij shteti dhe kur pala kontraktuese është një organizatë ndërqeveritare, aktet ligjore nën të cilat ajo organizatë ndërqeveritare vepron;

vi. referencat për “disenjo industriale” do të interpretohen si referenca për “disenjot industriale”, ku aplikimi ose regjistrimi përfshin më shumë se një disenjo industriale;

vii. referencat për një “person” do të interpretohen si referenca për një person fizik ashtu edhe për një person juridik;

viii. “Procedura para zyrës” do të thotë çdo procedurë në proceset para zyrës, në lidhje me një aplikim ose regjistrim;

ix. “Komunikim” do të thotë çdo aplikim ose çdo kërkesë, deklaratë, dokument, korrespondencë ose informacion tjetër, në lidhje me një aplikim ose regjistrim, i cili paraqitet në zyrë;

x. “Të dhënat e zyrës” nënkupton mbledhjen e informacionit të mbajtur nga zyra, në lidhje me dhe duke përfshirë përmbajtjen e aplikimeve dhe regjistrimeve, pa marrë parasysh mjetin në të cilin ruhet ky informacion;

xi. “Aplikant” nënkupton personin të cilin tregojnë të dhënat e zyrës, në përputhje me ligjin në fuqi, si personin që po aplikon për regjistrim ose si një person tjetër që po paraqet, ose përfaqëson aplikimin;

xii. “Mbajtës” nënkupton personin që tregohet në regjistrimet e zyrës si mbajtës i regjistrimit;

xiii. “Konventa e Parisit” nënkupton Konventën e Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale, e nënshkruar më 20 mars 1883, e rishikuar dhe e ndryshuar;

xiv. “Licencë” nënkupton një licencë për përdorimin e një disenjoje industriale sipas ligjit të një pale kontraktuese;

xv. “Licencues” nënkupton personin të cilit i është dhënë një licencë;

xvi. “Rregullore” do të thotë rregulloret e përmendura në nenin 25;

xvii. “Konferencë Diplomatike” nënkupton mbledhjen e palëve kontraktuese për qëllimin e rishikimit të Traktatit;

xviii. “Asambleja” nënkupton Asamblenë e përmendur në nenin 26;

xix. Referencat për një “instrument ratifikimi” do të interpretohen si përfshirje e referencave për instrumente pranimi dhe miratimi;

xx. “Organizata” nënkupton Organizatën Botërore të Pronësisë Intellektuale;

xxi. “Byroja Ndërkombëtare” nënkupton Byronë Ndërkombëtare të Organizatës;

xxii. “Drejtori i përgjithshëm” nënkupton drejtorin e përgjithshëm të Organizatës;

xxiii. Referencat për një “nen” ose për një “paragraf”, “nënparagraf” ose “pikë” të një neni do të interpretohen se përfshijnë referenca për rregullat përkatëse sipas rregulloreve.

Neni 2

Parimet e përgjithshme

1. *[Asnjë Rregullim për Ligjin Material për disenjot industriale]* Asgjë në këtë Traktat ose rregullore nuk synohet të interpretohet si një përcaktim që do të kufizonte lirinë e një pale kontraktuese për të përcaktuar kërkesa të tilla të ligjit material, në lidhje me disenjot industriale sipas dëshirës së saj.

2. *[Lidhja me traktatet e tjera]* Asgjë në këtë Traktat nuk do të shmangë detyrimet që palët kontraktuese kanë ndaj njëra-tjetrës sipas ndonjë traktati tjetër.

3. *[Kërkesat më të përshtatshme]* Një palë kontraktuese do të jetë e lirë të parashikojë kërkesa të cilat, nga pikëpamja e aplikantëve dhe mbajtësve, janë më të përshtatshme sesa kërkesat e përmendura në këtë Traktat dhe në rregulloret, përveç nenit 6.

Neni 3

Aplikimet dhe disenjot industriale për të cilat zbatohet ky Traktat

1. *[Aplikimet]* Ky Traktat do të zbatohet për aplikimet kombëtare dhe rajonale të cilat depozitohen pranë ose për zyrën e një pale kontraktuese [dhe për aplikimet e ndara të saj].

2. *[Disenjt industrial]* Ky Traktat do të zbatohet për disenjt industriale që mund të regjistrohen si diseno industriale, ose për të cilat mund të jepen patenta, sipas ligjit në fuqi.

Neni 4 **Aplikimi**

1. *[Përmbajtja e aplikimit; tarifa]* a) Një palë kontraktuese mund të kërkojë që një aplikim të përmbajë disa ose të gjithë treguesit ose elementet e mëposhtme:

- i. një kërkesë për regjistrim;
- ii. emrin dhe adresën e aplikantit;
- iii. kur aplikanti ka një përfaqësues, emrin dhe adresën e atij përfaqësuesi;
- iv. kur kërkohet një adresë dorëzimi ose një adresë për korrespondencë sipas nenit 5/3, kjo adresë;
- v. një paraqitje e disenjos industriale, siç përshkruhet në rregullore;
- vi. një tregues të produktit ose produkteve që përfshijnë disenjon industriale, ose në lidhje me të cilin do të përdoret disenjoja industriale;
- vii. kur aplikanti dëshiron të përfitojë nga prioriteti i një aplikimi të mëparshëm, një deklaratë që pretendon prioritetin e aplikimit të mëparshëm, së bashku me treguesit dhe provat në mbështetje të deklaratës që mund të kërkohet në përputhje me nenin 4 të Konventës së Parisit;

viii. ku aplikanti dëshiron të përfitojë nga neni 11 i Konventës së Parisit, prova që produkti ose produktet që përfshijnë diseno industriale ose në lidhje me të cilin do të përdoret disenjoja industriale, të jenë shfaqur në një ekspozitë ndërkombëtare zyrtare ose të njohur zyrtarisht;

ix. çdo tregues ose element të mëtejshëm të përshkruar në rregullore;

b) Në lidhje me aplikimin, mund të kërkohet pagesa e një tarife.

2. *[Treguesi i informacionit]* Një palë kontraktuese mund të kërkojë, kur lejohet sipas ligjit të zbatueshëm, që një aplikim të përmbajë një tregues të çdo aplikimi ose regjistrimi të mëparshëm, ose të informacionit tjetër, duke përfshirë informacionin mbi shprehjet kulturore tradicionale dhe njohuritë tradicionale, për të cilat aplikanti është në dijeni, që është i rëndësishëm për pranim për regjistrimin e disenjos industriale.

3. *[Ndalimi i kërkesave të tjera]* Asnjë tregues ose element, përveç atyre të përmendura në paragrafët 1 dhe 2, në nenin 12, nuk mund të kërkohet në lidhje me aplikimin.

4. *[Disa diseno industriale në të njëjtin aplikim]* Në bazë të kushteve të tilla që mund të përcaktohen sipas ligjit në fuqi, një aplikim mund të përfshijë më shumë se një diseno industriale.

5. *[Provat]* Një pale kontraktuese mund t'i kërkohej prova nga zyra kur gjatë shqyrtimit të aplikimit, zyra mund të dyshojë në mënyrë të arsyeshme në vërtetësinë e ndonjë treguesi ose elementi të përfshirë në aplikim.

Neni 5 **Përfaqësuesit; adresa për dorëzimin ose adresa për korrespondencë**

1. *[Përfaqësuesit e pranuar në procedurë]* a) Një palë kontraktuese mund të kërkojë që një përfaqësues i caktuar për qëllimet e çdo procedure përpara zyrës

- i. ka të drejtë, sipas ligjit në fuqi, të veprojë para zyrës në lidhje me aplikimet dhe regjistrimet;
- ii. të sigurojë, si adresë të tij, një adresë në një territor të përshkruar nga pala kontraktuese;

b) Një akt në lidhje me çdo procedurë përpara zyrës, nga ose në lidhje me një përfaqësues që përmbush kërkesat e përcaktuara nga pala kontraktuese sipas nënparagrafit “a”, do të ketë efektin e një akti nga ose në lidhje me aplikantin, mbajtësin ose çdo person tjetër të interesuar që e ka caktuar atë përfaqësues.

2. *[Përfaqësimi i detyrueshëm]* a) Në bazë të nënparagrafit “b”, një palë kontraktuese mund të kërkojë që për qëllimet e çdo procedure përpara zyrës, një aplikant, mbajtës ose person tjetër i

interesuar që nuk ka as vendbanim, as një ndërmarrje reale dhe efektive industriale ose tregtare në territorin e saj, të caktojë një përfaqësues;

b) Një aplikant, mbajtës ose person tjetër i interesuar që nuk ka as vendbanim, as një ndërmarrje reale dhe efektive industriale ose tregtare në territorin e palës kontraktuese mund të veprojë vetë para zyrës për paraqitjen e një aplikimi, për qëllim të datës së depozitimit dhe për pagesën e një tarife.

3. [Adresa për dorëzimin ose adresa për korrespondencë] Një palë kontraktuese, nëse nuk kërkon përfaqësim në përputhje me paragrafin 2, mund të kërkojë që për ndjekjen e çdo procedure përpara zyrës, një aplikant, mbajtës ose një person tjetër i interesuar që nuk ka as vendbanim, as një ndërmarrje reale dhe efektive industriale, ose tregtare në territorin e tij, do të ketë një adresë dorëzimi, ose një adresë për korrespondencë, në një territor të përcaktuar nga pala kontraktuese.

4. [Emërimi i një përfaqësuesi] Një palë kontraktuese do të pranojë që emërimi i një përfaqësuesi të dorëzohet në zyrë në mënyrën e përcaktuar në rregullore.

5. [Ndalimi i kërkesave të tjera] Sipas kërkesave të nenit 12, asnjë palë kontraktuese nuk mund të kërkojë që të përmbushen kërkesa, përveç atyre të përmendura në paragrafët 1 deri në 4, në lidhje me çështjet e trajtuara në ato paragrafë.

6. [Njoftimi] Kur një ose më shumë nga kërkesat e aplikuara nga pala kontraktuese, sipas paragrafëve 1 deri në 4, nuk përmbushen, zyra do të njoftojë aplikuesin, mbajtësin ose personin tjetër të interesuar, duke i dhënë mundësinë për të përmbushur çdo kërkesë të tillë brenda afatit kohor të përcaktuar në rregullore.

7. [Mospërputhja me kërkesat] Kur një ose më shumë nga kërkesat e aplikuara nga pala kontraktuese, sipas paragrafëve 1 deri në 4 përmbushen ose nuk përmbushen brenda afatit kohor të përcaktuar në rregullore, pala kontraktuese mund të zbatojë sanksionin e parashikuar në ligjin e saj.

Neni 6

Data e depozitimit

1. [Kërkesat e lejuara] a) Në bazë të nënparagrafit “b” dhe paragrafit 2, pala kontraktuese do të marrë si datë depozitimi të një aplikimi datën në të cilën zyra merr të dhënat dhe elementet e mëposhtme, në një gjuhë të pranuar nga zyra:

- i. një tregues i shprehur ose i nënkuptuar që tregon se elementet synohen të jenë një aplikim;
- ii. treguesit që lejojnë përcaktimin e identitetit të aplikantit;
- iii. një paraqitje mjaftueshëm të qartë të disenjës industriale;
- iv. treguesit që lejojnë aplikantin ose përfaqësuesin e aplikantit, nëse ka, të jetë kontaktuar;

b) Një palë kontraktuese mund të caktojë si datë regjistrimi të një aplikimi, datën kur zyra merr, së bashku me një paraqitje mjaftueshëm të qartë të disenjës industriale dhe treguesve që lejojnë identifikimin e aplikantit ose kontaktimin e aplikantit ose përfaqësuesit të aplikantit, nëse ka, disa, por jo të gjithë, nga treguesit dhe elementet e përmendura në nënparagrafin “a” ose i merr ato në një gjuhë tjetër përveç gjuhës së pranueshme nga zyra.

2. [Kërkesat shitesë të lejuara] a) Një palë kontraktuese, ligji i së cilës, në kohën kur bëhet palë në këtë Traktat, kërkon që një aplikim të jetë në përputhje me ndonjë nga kërkesat e specifikuar në nënparagrafin “b”, në mënyrë që atij aplikimi t’i jepet një datë depozitimi, me anë të një deklarate mund të njoftojë drejtorin e përgjithshëm për këto kërkesa;

b) Kërkesat që mund të njoftohen në përputhje me nënparagrafin “a” janë, si më poshtë:

i. një tregues të produktit ose produkteve që përfshijnë disenjon industriale ose në lidhje me të cilin do të përdoret disenjoja industriale;

ii. një përshkrim të shkurtër të riprodhimit ose të veçorive karakteristike të disenjës industriale;

iii. një kërkesë;

iv. pagesën e tarifave të kërkuara;

v. treguesit në lidhje me identitetin e krijuesit të disenjës industriale;

c) Çdo deklaratë e njoftuar sipas nënparagrafit “a”, mund të tërhiqet në çdo kohë.

3. [Ndalimi i kërkesave të tjera] Asnjë tregues ose element tjetër përveç atyre të përmendur në paragrafin 1 “a” dhe 2 “b” nuk mund të kërkohet për qëllimin e një date depozitimi në një aplikim.

4. *[Njoftimi dhe afatet kohore]* Kur aplikimi në kohën e marrjes së tij nga zyra nuk përputhet me një ose më shumë nga kërkesat që duhen zbatuar sipas paragrafëve 1 dhe 2 “b”, zyra do të njoftojë aplikantin dhe do t’i japë mundësinë që të përmbushë këto kërkesa brenda afatit kohor të përcaktuar në rregullore.

5. *[Data e depozitimit në rast të përmbushjes së mëvonshme të kërkesave]* Nëse, brenda afatit kohor të përmendur në paragrafin 4, aplikanti përmbush kërkesat që duhen zbatuar, data e depozitimit do të jetë jo më vonë se data në të cilën të gjithë treguesit dhe elementet e kërkuara nga pala kontraktuese, sipas paragrafëve 1 dhe 2 “b” pranohen nga zyra. Përndryshe, aplikimi do të trajtohet sikur të mos ishte paraqitur.

Neni 7

Periudha e tolerancës për paraqitjen e aplikimit në rast të zbulimit

Nëse disenjoja industriale do të zbulohet në publik gjatë një periudhe prej 12 muajsh përpara datës së depozitimit të aplikimit ose, nëse kërkohet prioritet, datës së prioritetit, nuk do të cenojë risinë dhe/ose origjinalitetin, dhe sipas rastit, karakterin individual ose dallueshmërinë e disenjës industriale, kur zbulimi është bërë:

- i. nga krijuesi ose pasuesi i tij/saj në titull; ose
- ii. nga një person i cili ka marrë informacionin e zbuluar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, duke përfshirë edhe si rezultat i një abuzimi, nga krijuesi ose pasuesi i tij/saj në titull.

Neni 8

Kërkesa për të paraqitur aplikimin në emër të krijuesit

1. *[Kërkesa që aplikimi të dorëzohet në emër të krijuesit]* Një palë kontraktuese mund të kërkojë që aplikimi të depozitohet në emër të krijuesit të disenjës industriale.

2. *[Formaliteti kur ka një kërkesë për të depozituar aplikimin në emër të krijuesit]* Kur një palë kontraktuese kërkon që aplikimi të depozitohet në emër të krijuesit të disenjës industriale, kjo kërkesë do të konsiderohet e plotësuar, nëse emri i krijuesit të disenjës industriale tregohet si i tillë në aplikim dhe:

- i. ai emër korrespondon me emrin e aplikantit; ose
- ii. aplikimi shoqërohet ose përmban një deklaratë të transferimit nga krijuesi tek aplikuesi, e nënshkruar nga krijuesi i disenjës industriale.

Neni 9

Ndryshimi ose ndarja e aplikimit që përfshin më shumë se një disenjo industriale

1. *[Ndryshimi ose ndarja e aplikimit]* Nëse një aplikim që përfshin më shumë se një disenjo industriale (në vijim “aplikimi fillestar”) nuk përputhet me kushtet e përcaktuara nga pala kontraktuese e interesuar në përputhje me nenin 4/4, zyra mund të kërkojë nga aplikanti, sipas mundësisë të aplikantit:

- i. të ndryshojë aplikimin fillestar për të përmbushur këto kushte; ose
- ii. të ndajë aplikimin fillestar në dy ose më shumë aplikime të ndara që përputhen me këto kushte, duke shpërndarë midis këtyre të fundit disenjot industriale për të cilat është kërkuar mbrojtja në aplikimin fillestar.

2. *[Data e depozitimit dhe e drejta e prioritetit të aplikimeve të ndara]* Aplikimet e ndara do të ruajnë datën e depozitimit të aplikimit fillestar dhe përfitojnë kërkesën për prioritet, nëse është e zbatueshme.

3. Në zbatim të ligjit në fuqi, atje ku mund të lejohet, aplikanti mund, gjithashtu, me iniciativën e tij, të ndajë një aplikim në dy ose më shumë aplikime të ndara.

4. *[Tarifat]* Ndarja e një aplikimi mund të jetë objekt i pagesës së tarifave.

Neni 10
Publikimi i disenjos industriale

1. *[Mbajtja e disenjos industriale e papublikuar]* Një palë kontraktuese do të lejojë që disenjoja industriale të mbahet e papublikuar për një periudhë të caktuar nga ligji në fuqi, duke iu nënshtruar periudhës minimale të përcaktuar në rregullore.

2. *[Kërkesa për të mbajtur disenjon industriale të papublikuar; tarifa]* a) Një palë kontraktuese mund të kërkojë që aplikanti t'i bëjë kërkesë zyrës për qëllime të mbajtjes së disenjos industriale të papublikuar sipas paragrafit 1.

b) Zyra mund të kërkojë pagesën e një tarife në lidhje me kërkesën për ruajtjen e disenjos industriale të papublikuar sipas nënparagrafit "a".

3. *[Kërkesa për publikim në vijim të një kërkesë për të mbajtur disenjon të papublikuar]* Kur një kërkesë për të mbajtur disenjon industriale të papublikuar është bërë sipas paragrafit 2 "a", aplikanti ose mbajtësi, sipas rastit, në çdo kohë gjatë periudhës së lejuar sipas paragrafit 1, mund të kërkojë publikimin e disenjos industriale.

Neni 11
Sistemi elektronik për disenjon industriale

Një palë kontraktuese, në përputhje me legjislationin e saj në fuqi, do të përpiqet të ofrojë një sistem për aplikimet elektronike dhe inkurajohet të sigurojë shkëmbimin elektronik të dokumenteve të prioritetit.

Neni 12
Komunikimet

1. *[Mjetet e transmetimit dhe forma e komunikimit]* Një palë kontraktuese mund të zgjedhë mjetet e transmetimit të komunikimit dhe të zgjedhë nëse do të pranojë komunikimet në letër, komunikimet në formë elektronike ose çdo formë tjetër komunikimi.

2. *[Gjuha e komunikimit]* a) Një palë kontraktuese mund të kërkojë që çdo komunikim të jetë në një gjuhë të pranuar nga zyra;

b) Një palë kontraktuese mund të kërkojë që, kur një komunikim nuk është në një gjuhë të pranuar nga zyra e saj të sigurohet një përkthim i atij komunikimi nga një përkthyes zyrtar ose përfaqësues, në një gjuhë të pranuar nga zyra, brenda një afati të arsyeshëm kohor;

c) Asnjë palë kontraktuese nuk mund të kërkojë vërtetimin, noterizimin, legalizimin ose çdo vërtetim tjetër të ndonjë përkthimi të komunikimit, me përjashtim të rasteve të parashikuara në këtë Traktat;

d) Pavarësisht nga nënparagrafi "c", një palë kontraktuese mund të kërkojë që çdo përkthim i një komunikimi të shoqërohet me një deklaratë se përkthimi është i vërtetë dhe i saktë.

3. *[Adresa për korrespondencë, adresa për dorëzimin dhe detajet e kontaktit]* Një palë kontraktuese, në bazë të ndonjë dispozite të përcaktuar në rregullore, mund të kërkojë që një aplikant, mbajtës ose person tjetër i interesuar, të tregojë në çdo komunikim:

i. një adresë për korrespondencë;

ii. një adresë dorëzimi;

iii. çdo adresë tjetër ose detaje kontakti të parashikuara në rregullore.

4. *[Nënshkrimi i komunikimeve në letër]* a) Një palë kontraktuese mund të kërkojë që një komunikim në letër të nënshkruhet nga aplikanti, mbajtësi ose person tjetër i interesuar. Kur një palë kontraktuese kërkon që të nënshkruhet një komunikim në letër, ajo palë kontraktuese do të pranojë çdo nënshkrim që përputhet me kërkesat e përcaktuara në rregullore;

b) Asnjë palë kontraktuese nuk mund të kërkojë vërtetimin, noterizimin, autentifikimin, legalizimin ose vërtetimin tjetër të ndonjë nënshkrimi, përveç në lidhje me çdo procedurë gjyqësore ose në ato raste të parashikuara në rregullore;

c) Pavarësisht nga nënparagrafi “b”, një palë kontraktuese mund të kërkojë që provat të depozitohen në zyrë, kur zyra mund të dyshojë në mënyrë të arsyeshme vërtetësinë e çdo nënshkrimi të një komunikimi në letër.

5. *[Komunikimet e paraqitura në formë elektronike ose me mjete elektronike të transmetimit]* Kur një palë kontraktuese lejon paraqitjen e komunikimeve në formë elektronike ose me mjete elektronike të transmetimit, ajo mund të kërkojë që çdo komunikim i tillë të jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në rregullore.

6. *[Ndalimi i kërkesave të tjera]* Asnjë palë kontraktuese nuk mund të kërkojë që, në lidhje me paragrafët 1 deri në 5 të përmbushen kërkesa të ndryshme nga ato të përmendura në këtë nen.

7. *[Treguesit në komunikime]* Një palë kontraktuese mund të kërkojë që çdo komunikim të përmbajë një ose më shumë tregues të përshkruar në rregullore.

8. *[Mënyrat e komunikimit me përfaqësuesin]* Asgjë në këtë nen nuk rregullon mjetet e komunikimit ndërmjet një aplikanti, mbajtësi ose personi tjetër të interesuar dhe përfaqësuesit të çdo personi të tillë.

Neni 13

Rinovimi

1. *[Kërkesa për rinovim; tarifa]* a) Kur një palë kontraktuese parashikon rinovimin e afatit të mbrojtjes, ajo mund të kërkojë që rinovimi të jetë objekt i paraqitjes së një kërkesë dhe një kërkesë e tillë duhet të përmbajë disa ose të gjithë treguesit e mëposhtëm:

- i. një tregues që kërkohet rinovimi;
- ii. emrin dhe adresën e mbajtësit;
- iii. numrin(at) e regjistrimit(eve) të lidhura me rinovimin;
- iv. një tregues të afatit të mbrojtjes për të cilën kërkohet rinovimi;
- v. kur mbajtësi ka një përfaqësues, emrin dhe adresën e atij përfaqësuesi;
- vi. kur mbajtësi ka një adresë dorëzimi ose një adresë për korrespondencë duhet të jepet kjo adresë;
- vii. kur lejohet që rinovimi të bëhet vetëm për disa prej disenjove industriale të përfshira në regjistrim, dhe kërkohet një rinovim i tillë, duhet të jepet një tregues i numrit(ave) të disenjove industriale për të cilat kërkohet ose nuk kërkohet rinovimi;
- viii. kur lejohet që një kërkesë për rinovim të paraqitet nga një person tjetër përveç mbajtësit ose përfaqësuesit të tij, dhe kërkesa paraqitet nga ky person, duhet të jepen emri dhe adresa e atij personi;

b) Në lidhje me rinovimin, një palë kontraktuese mund të kërkojë që t’i paguhet zyrës një tarifë.

2. *[Afati kohor për paraqitjen e kërkesës për rinovim dhe pagesën e tarifës]* Një palë kontraktuese mund të kërkojë që të paraqitet kërkesa për rinovim e përmendur në paragrafin 1 “a” dhe tarifa përkatëse e përmendur në paragrafin 1 “b” t’i paguhet zyrës brenda një afati kohor të caktuar nga ligji i palës kontraktuese, duke iu nënshtruar periudhave minimale të përcaktuara në rregullore.

3. *[Ndalimi i kërkesave të tjera]* Asnjë palë kontraktuese nuk mund të kërkojë që të përmbushen kërkesa të ndryshme nga ato të përmendura në paragrafët 1 dhe 2 dhe në nenin 12, në lidhje me kërkesën për rinovim.

Neni 14

Lehtësimi në lidhje me afatet kohore

1. *[Zgjatja e afateve kohore]* Një palë kontraktuese për periudhën e përcaktuar në rregullore, mund të parashikojë zgjatje e një afati kohor të caktuar nga zyra për një veprim në një procedurë para zyrës, nëse për këtë është paraqitur kërkesë pranë zyrës, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në rregullore dhe kërkesa paraqitet sipas zgjedhjes së palës kontraktuese:

- i. para përfundimit të afatit kohor; ose
- ii. pas përfundimit të afatit kohor, dhe brenda afatit kohor të përcaktuar në rregullore.

2. *[Vazhdimi i procesit]* Kur një aplikant ose mbajtës nuk ka përmbushur një afat kohor të caktuar nga zyra e një palë kontraktuese për një veprim në një procedurë para zyrës, dhe kjo palë kontraktuese nuk parashikon zgjatjen e një afati kohor sipas paragrafi 1, pala kontraktuese duhet të parashikojë vazhdimin e procesit, në lidhje me aplikimin ose regjistrimin dhe, nëse është e nevojshme, rikthimin e të drejtave të aplikantit ose mbajtësit në lidhje me atë aplikim ose regjistrim:

- i. për këtë i bëhet zyrës një kërkesë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në rregullore;
- ii. kërkesa është paraqitur dhe të gjitha kërkesat për veprimin e përmendur, për të cilin aplikohet afati, janë përmbushur brenda afatit të parashikuar në rregullore.

3. *[Përjashtimet]* Nuk do të ketë kërkesë për të parashikuar zgjatjen e afateve kohore sipas paragrafit 1 ose vijimin e procesit sipas paragrafit 2, në lidhje me përjashtimet e përkrahura në rregullore.

4. *[Tarifat]* Një palë kontraktuese mund të kërkojë që të paguhet një tarifë në lidhje me një kërkesë sipas paragrafëve 1 ose 2.

5. *[Ndalimi i kërkesave të tjera]* Asnjë palë kontraktuese nuk mund të kërkojë që kërkesat e tjera, përveç atyre të përmendura në paragrafët 1 deri në 4, të përmbushen në lidhje me lehtësimin e parashikuar në paragrafët 1 ose 2, përveç nëse parashikohet ndryshe nga ky Traktat ose përcaktohet në rregullore.

6. *[Mundësia për të bërë vërejtje në rast të refuzimit të përcaktuar]* Një kërkesë sipas paragrafëve 1 ose 2 nuk mund të refuzohet pa i dhënë aplikantit, ose mbajtësit mundësinë për të bërë vërejtje mbi refuzimin e përcaktuar brenda një afati të arsyeshëm.

Neni 15

Rivendosja e të drejtave pas një konstatimi nga zyra për kujdes të duhur ose pavullnetshmëri

1. *[Rivendosja e të Drejtave]* Nëse një palë kontraktuese nuk parashikon një masë lehtësuese sipas nenit 14/1 “ii” ose 14/2, zyra do të rivendosë të drejtat e aplikantit ose mbajtësit, në lidhje me atë aplikim ose regjistrim, kur një aplikant ose mbajtës nuk ka respektuar afat kohor për veprim në një procedurë para zyrës dhe ky mosrespektim ka pasur pasojën direkte të shkaktit të humbjes së të drejtave, në lidhje me një aplikim ose regjistrim, nëse:

- i. për këtë i bëhet zyrës një kërkesë, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në rregullore;
- ii. kërkesa është paraqitur dhe të gjitha kërkesat për veprimin në fjalë, për të cilin aplikohet afati kohor, janë përmbushur brenda afatit të përcaktuar në rregullore;
- iii. kërkesa tregon arsyet e mosrespektimit të afatit; dhe
- iv. zyra konstaton se mosrespektimi i afatit kohor ka ndodhur pavarësisht se ishte treguar kujdesi i duhur sipas rrethanave ose, sipas zgjedhjes së palës kontraktuese, se çdo vonesë ishte e paqëllimshme (e pavullnetshme).

2. *[Përjashtimet]* Nuk do të ketë kërkesë për të parashikuar rivendosjen e të drejtave sipas paragrafit 1, në lidhje me përjashtimet e përcaktuara në rregullore.

3. *[Tarifat]* Një palë kontraktuese mund të kërkojë që të paguhet një tarifë në lidhje me një kërkesë sipas paragrafit 1.

4. *[Provat]* Një palë kontraktuese mund të kërkojë të depozitohen në zyrë një deklaratë ose prova të tjera në mbështetje të arsyeve të përmendura në paragrafin 1 “iii” brenda një afati kohor të caktuar nga zyra.

5. *[Mundësia për të bërë vërejtje në rast refuzimi të përcaktuar]* Kërkesa sipas paragrafit 1 nuk mund të refuzohet, tërësisht ose pjesërisht, pa i dhënë palës kërkuuese mundësinë për të bërë vërejtje mbi refuzimin e synuar, brenda një afati të arsyeshëm kohor.

Neni 16

Korrigjimi ose shtimi i kërkesës për prioritet; rivendosja e të drejtës së prioritetit

1. *[Korrigjimi ose shtimi i kërkesës për prioritet]* Një palë kontraktuese do të parashikojë korrigjimin ose shtimin e një pretendimi për prioritet në lidhje me një aplikim (“aplikimi i mëparshëm”), nëse:

- i. për këtë i bëhet zyrës kërkesë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në rregullore;
- ii. kërkesa paraqitet brenda afatit të përcaktuar në rregullore; dhe
- iii. data e depozitimit të aplikimit të mëvonshëm nuk është më vonë se data e përfundimit të periudhës së prioritetit, e llogaritur nga data e depozitimit të aplikimit të mëparshëm, prioriteti i të cilit pretendohet.

2. *[Paraqitja e vonuar e aplikimit të mëvonshëm]* Një palë kontraktuese duhet të parashikojë që kur një aplikim (“aplikimi i mëvonshëm”) që pretendon ose mund të ketë pretenduar prioritetin e një aplikimi të mëparshëm, ka një datë depozitimi që është më vonë sesa data në të cilën ka përfunduar periudha e prioritetit, por brenda afatit kohor të përcaktuar në rregullore, zyra do të rivendosë të drejtën e prioritetit, nëse:

- i. për këtë i bëhet zyrës kërkesë, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në rregullore;
- ii. kërkesa paraqitet brenda afatit të përcaktuar në rregullore;
- iii. kërkesa përmban arsyet për mospërmbushjen e periudhës së prioritetit; dhe
- iv. zyra konstaton se mosparaqitja e kërkesës së mëvonshme brenda periudhës së prioritetit, ka ndodhur pavarësisht nga kujdesi i duhur sipas rrethanave ose sipas zgjedhjes së palës kontraktuese, çdo vonesë ishte e paqëllimshme.

3. *[Tarifat]* Një palë kontraktuese mund të kërkojë që të paguhet tarifë në lidhje me një kërkesë sipas paragrafit 1 dhe në lidhje me një kërkesë sipas paragrafit 2.

4. *[Provat]* Një palë kontraktuese mund të kërkojë që të depozitohen në zyrë një deklaratë ose prova të tjera në mbështetje të arsyeve të përmendura në paragrafin 2 “iii”, brenda një afati kohor të caktuar nga zyra.

5. *[Mundësia për të bërë vërejtje në rast refuzimi të synuar]* Një kërkesë sipas paragrafëve 1 ose 2 nuk mund të refuzohet, plotësisht ose pjesërisht, pa i dhënë palës kërkuese mundësinë për të bërë vërejtje mbi refuzimin e synuar brenda një afati të arsyeshëm kohor.

Neni 17

Kërkesa për regjistrimin e një licence ose interesi garancie

1. *[Kërkesat në lidhje me kërkesën për regjistrimin e një licence]* Kur ligji i një pale kontraktuese parashikon regjistrimin e një licence në zyrën e saj, kjo palë kontraktuese mund të kërkojë që kërkesa për regjistrim:

- i. të dorëzohet në përputhje me kërkesat e përcaktuara në rregullore; dhe
- ii. të shoqërohet me dokumentet mbështetëse të përcaktuara në rregullore.

2. *[Tarifat]* Në lidhje me regjistrimin e licencës, zyra mund të kërkojë pagesën e një tarife.

3. *[Kërkesa e vetme]* Një kërkesë e vetme do të jetë e mjaftueshme edhe kur licenca lidhet me më shumë se një regjistrim, me kusht që numrat e të gjithë regjistrimeve në fjalë janë të shënuar në kërkesë, mbajtësi dhe i licencuari janë të njëjtë për të gjitha regjistrimet, dhe kërkesa tregon qëllimin e licencës në lidhje me të gjitha regjistrimet.

4. *[Ndalimi i kërkesave të tjera]* a) Asnjë kërkesë tjetër përveç atyre të përmendura në paragrafët 1 deri në 3 dhe në nenin 12, nuk mund të kërkojë në lidhje me regjistrimin e një licence në zyrën e saj. Në veçanti, sa më poshtë mund të mos kërkojë:

- i. ofrimi i certifikatës së regjistrimit të disenjës industriale që është objekt i licencës;
- ii. një tregues i kushteve financiare të kontratës së licencës;

b) Nënparagrafi “a” nuk cenon asnjë detyrim ekzistues sipas ligjit të një pale kontraktuese, në lidhje me zbardhjen e informacionit për qëllime të tjera përveç regjistrimit të licencës.

5. *[Provat]* Mund të kërkojë të ofrohen prova pranë zyrës, kur zyra mund të dyshojë në mënyrë të arsyeshme në vërtetësinë e ndonjë treguesi të përfshirë në kërkesë ose në ndonjë dokument mbështetës.

6. *[Kërkesat në lidhje me aplikimet]* Paragrafët 1 deri në 5 do të zbatohen, *mutatis mutandis*, për kërkesat për regjistrimin e një licence në lidhje me një aplikim, kur ligji i një pale kontraktuese parashikon një regjistrim të tillë.

7. *[Kërkesa për regjistrimin e një interesi garancie]* Përveç paragrafit 4/a “ii”, paragrafët 1 deri në 5 do të zbatohen, *mutatis mutandis*, për kërkesat për regjistrimin e një interesi të garancisë në lidhje me një aplikim ose regjistrim.

Neni 18

Kërkesa për ndryshim ose anulim të regjistrimit të një licence ose interesi garancie

1. *[Kërkesat në lidhje me kërkesën për ndryshim ose anulim të regjistrimit të një licence]* Kur ligji i një pale kontraktuese parashikon regjistrimin e një licence në zyrën e saj, ajo palë kontraktuese mund të kërkojë që kërkesa për ndryshim ose anulim të regjistrimit të një licence:

- i. të dorëzohet në përputhje me kërkesat e përcaktuara në rregullore; dhe
- ii. të shoqërohet me dokumentet mbështetëse të përcaktuara në rregullore.

2. *[Kërkesat në lidhje me kërkesën për anulimin e regjistrimit të një interesi garancie]* Paragrafi 1 do të zbatohet, *mutatis mutandis*, për kërkesat për anulimin e regjistrimit të një interesi garancie.

3. *[Kërkesa të tjera]* Neni 17/2 deri në 7 do të zbatohet, *mutatis mutandis*, për kërkesat për ndryshim ose anulim të regjistrimit të një licence dhe për kërkesat për anulimin e regjistrimit të një interesi garancie.

Neni 19

Efektet e mosregjistrimit të një licence

1. *[Vlefshmëria e regjistrimit dhe mbrojtjes së disenjosh industriale]* Mosregjistrimi i një licence në zyrë ose në ndonjë autoritet tjetër të një pale kontraktuese nuk do të ndikojë në vlefshmërinë e regjistrimit të disenjosh industriale që është objekt i licencës, as mbrojtjen e asaj disenjoje industriale.

2. *[Disa të drejta të të licencuarit]* Një palë kontraktuese nuk mund të kërkojë regjistrimin e një licence si kusht për çdo të drejtë që i licencuari mund të ketë sipas ligjit të asaj pale kontraktuese për t’iu bashkuar procedurave të shkeljes të iniciuara nga mbajtësi, ose për të marrë, me anë të këtyre procedurave, dëmet që rrjedhin nga një shkelje e disenjosh industriale që është objekt i licencës.

Neni 20

Treguesi i licencës

Kur ligji i një pale kontraktuese kërkon një tregues që disenjo industriale përdoret nën një licencë, mospërputhja e plotë ose e pjesshme me këtë kërkesë nuk do të ndikojë në vlefshmërinë e regjistrimit të disenjosh industriale që është objekt i licencës, as mbrojtjen e asaj disenjoje industriale.

Neni 21

Kërkesa për regjistrimin e një ndryshimi në pronësi

1. *[Kërkesat në lidhje me kërkesën për regjistrim]* a) Kur ka një ndryshim në personin e mbajtësit, një palë kontraktuese do të pranojë që një kërkesë për regjistrimin e ndryshimit të bëhet ose nga mbajtësi, ose nga pronari i ri;

b) Një palë kontraktuese mund të kërkojë që kërkesa të përmbajë disa ose të gjithë treguesit e përshkruar në rregullore.

2. *[Kërkesat në lidhje me dokumentet mbështetëse për regjistrimin e një ndryshimi në pronësi]* a) Kur ndryshimi i pronësisë rezulton nga një kontratë, një palë kontraktuese mund të kërkojë që kërkesa të shoqërohet, sipas zgjedhjes së palës që bën kërkesën, nga një nga elementet e parashikuara në rregullore;

b) Kur ndryshimi i pronësisë rezulton nga një bashkim, një palë kontraktuese mund të kërkojë që kërkesa të shoqërohet me një kopje të një dokumenti, i cili buron nga një autoritet kompetent dhe dëshmon bashkimin, siç është një kopje e një ekstrakti nga një regjistër tregtar dhe që ajo kopje të vërtetohet nga autoriteti që ka lëshuar dokumentin ose nga një noter publik ose ndonjë autoritet tjetër publik kompetent, në përputhje me dokumentin origjinal;

c) Kur ka një ndryshim në një ose më shumë, por jo të gjithë bashkëmbajtësve, dhe një ndryshim i tillë në pronësi rezulton nga një kontratë ose një bashkim, një palë kontraktuese mund të kërkojë që çdo bashkëmbajtës, në lidhje me të cilin nuk ka ndryshim të pronësisë, jep pëlqimin e tij të shprehur për ndryshimin e pronësisë, në një dokument të nënshkruar nga ky bashkëmbajtës;

d) Kur ndryshimi i pronësisë nuk vjen nga një kontratë ose një bashkim, por nga një arsye tjetër, për shembull, nga zbatimi i ligjit ose një vendim gjykatë, një palë kontraktuese mund të kërkojë që kërkesa të shoqërohet me një kopje të një dokumenti që vërteton ndryshimin dhe që ajo kopje të vërtetohet se është në përputhje me dokumentin origjinal nga autoriteti që ka lëshuar dokumentin ose nga një noter publik, ose ndonjë autoritet tjetër publik kompetent.

3. *[Tarifat]* Një palë kontraktuese mund të kërkojë që, në lidhje me kërkesën, t'i paguhet zyrës një tarifë.

4. *[Kërkesë e vetme]* Një kërkesë e vetme do të jetë e mjaftueshme edhe kur ndryshimi lidhet me më shumë se një regjistrim, me kusht që mbajtësi dhe pronari i ri të jenë të njëjtë për çdo regjistrim dhe të tregohen në kërkesë numrat e të gjitha regjistrimeve në fjalë.

5. *[Ndryshim në pronësinë e një aplikimi]* Paragrafët 1 deri në 4 do të zbatohen, *mutatis mutandis*, kur ndryshimi i pronësisë lidhet me një aplikim, me kusht që, kur numri i aplikimit në fjalë nuk është lëshuar ende nuk është i njohur për aplikantin ose përfaqësuesin e tij, kërkesa të identifikojë aplikimin siç është parashikuar në rregullore.

6. *[Ndalimi i kërkesave të tjera]* Asnjë palë kontraktuese nuk mund të kërkojë që kërkesa të tjera nga ato të përmendura në paragrafët 1 deri në 5 dhe në nenin 12 të përmbushen në lidhje me një kërkesë për regjistrimin e një ndryshimi në pronësi.

7. *[Provat]* Një palë kontraktuese mund të kërkojë që prova ose prova të mëtejshme kur zbatohet paragrafi 2 “b” ose “d” t’i jepen zyrës ku zyra dyshon në mënyrë të arsyeshme në vërtetësinë e ndonjë treguesi të përfshirë në kërkesë ose në ndonjë dokument të përmendur në këtë nen.

Neni 22

Ndryshime në emra ose adresa

1. *[Ndryshime në emrin ose adresën e mbajtësit]* a) Kur nuk ka ndryshim në personin e mbajtësit, por ka një ndryshim në emrin dhe/ose adresën e tij, secila palë kontraktuese do të pranojë që të bëhet nga mbajtësi një kërkesë për regjistrimin e ndryshimit nga zyra në një komunikim që tregon numrin e regjistrimit në fjalë dhe ndryshimin që do të regjistrohet;

b) Një palë kontraktuese mund të kërkojë që kërkesa të përmbajë disa ose të gjithë treguesit e përshkruar në rregullore;

c) Një palë kontraktuese mund të kërkojë që, në lidhje me kërkesën, t’i paguhet zyrës një tarifë;

d) Një kërkesë e vetme është e mjaftueshme edhe kur ndryshimi lidhet me më shumë se një regjistrim, me kusht që në kërkesë të tregohen numrat e të gjitha regjistrimeve në fjalë.

2. *[Ndryshimi në emrin ose adresën e aplikantit]* Paragrafi 1 do të zbatohet, *mutatis mutandis*, kur ndryshimi ka të bëjë me një aplikim ose aplikimet, ose me të dyja, një aplikim ose aplikimet dhe një regjistrim, ose regjistrimet, me kusht që, kur numri i aplikimit për çdo aplikim në fjalë nuk është lëshuar ende ose nuk është i njohur për aplikantin ose përfaqësuesin e tij, kërkesa përndryshe e identifikon atë kërkesë siç përcaktohet në rregullore.

3. *[Ndryshimi në emrin ose adresën e përfaqësuesit ose në adresën e dorëzimit]* Paragrafi 1 do të zbatohet, *mutatis mutandis*, për çdo ndryshim në emrin ose adresën e përfaqësuesit nëse ka, dhe për çdo ndryshim në lidhje me adresën e dorëzimit, nëse ka.

4. *[Ndalimi i kërkesave të tjera]* Asnjë palë kontraktuese nuk mund të kërkojë që kërkesa të tjera nga ato të përmendura në paragrafët 1 dhe 2, dhe në nenin 12 të përmbushen në lidhje me kërkesën e përmendur në këtë nen. Në veçanti, mund të mos kërkohej ofrimi i ndonjë certifikate në lidhje me ndryshimin.

5. *[Prova]* Një palë kontraktuese mund të kërkojë që zyrës t'i jepen prova kur zyra mund të dyshojë në mënyrë të arsyeshme vërtetësinë e ndonjë treguesi të përfshirë në kërkesë.

Neni 23

Korrigjimi i një gabimi

1. *[Kërkesë]* a) Kur një aplikim, një regjistrim ose ndonjë kërkesë e komunikuar në zyrë, në lidhje me një aplikim ose një regjistrim përmban një gabim që nuk lidhet me kërkimin ose shqyrtimin thelbësor, i cili është i korrigjueshëm nga zyra sipas ligjit në fuqi, zyra do të pranojë që të bëhet një kërkesë për korrigjimin e atij gabimi në të dhënat dhe publikimet e zyrës me anë të një komunikimi drejtuar zyrës dhe të nënshkruar nga aplikanti ose mbajtësi;

b) Një palë kontraktuese mund të kërkojë që kërkesa të shoqërohet nga një pjesë zëvendësuese ose pjesë që përmban korrigjimin ose, kur aplikohet paragrafi 3, nga një pjesë zëvendësuese ose pjesë që përmban korrigjimin për secilin aplikim dhe regjistrim të lidhur me kërkesën;

c) Një palë kontraktuese mund të kërkojë që kërkesa t'i nënshtrohet një deklaratë nga pala kërkuuese që deklaron se gabimi është bërë në mirëbesim;

d) Një palë kontraktuese mund të kërkojë që kërkesa të jetë objekt i një deklarimi nga pala që bën kërkesën që konstaton se kërkesa e përmendur është bërë pa vonesë të papërshtatshme ose, sipas zgjedhjes së palës kontraktuese, se ajo është bërë pa vonesë të qëllimshme, pas zbulimit të gabimit.

2. *[Tarifat]* a) Në bazë të nënparagrafit “b”, një palë kontraktuese mund të kërkojë që të paguhet një tarifë në lidhje me një kërkesë sipas paragrafit 1;

b) Zyra do të korrigjojë gabimet e veta, *sipas detyrës zyrtare* ose sipas kërkesës, pa pagesë.

3. *[Kërkesa e vetme]* Neni 21/4 do të zbatohet, *mutatis mutandis*, për kërkesat për korrigjimin e një gabimi, me kusht që gabimi dhe korrigjimi i kërkuar të jenë të njëjtë për të gjitha aplikimet dhe regjistrimet në fjalë.

4. *[Prova]* Një palë kontraktuese mund të kërkojë që provat në mbështetje të kërkesës të dorëzohen në zyrë vetëm kur zyra mund të dyshojë në mënyrë të arsyeshme se gabimi i pretenduar në fakt është një gabim, ose kur mund të dyshojë në mënyrë të arsyeshme mbi vërtetësinë e ndonjë çështjeje të përfshirë në ndonjë dokument të paraqitur, në lidhje me kërkesën për korrigjimin e një gabimi.

5. *[Ndalimi i kërkesave të tjera]* Asnjë palë kontraktuese nuk mund të kërkojë që të përmbushen kërkesa formale të ndryshme nga ato të përmendura në paragrafët 1 deri në 4, në lidhje me kërkesën e përmendur në paragrafin 1, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Traktat ose të përcaktuara në rregullore.

6. *[Përrjashtimet]* Një palë kontraktuese mund të përjashtojë zbatimin e këtij neni, në lidhje me çdo gabim që duhet të korrigjohet në atë palë kontraktuese sipas një procedure për ripublikimin e regjistrimit.

Neni 24

Asistenca teknike dhe ngritja e kapaciteteve

1. *[Parimet]* Ndihma teknike do:

i. të jetë e orientuar drejt zhvillimit, e bazuar në kërkesë, transparente, e fokusuar dhe e përshtatshme për forcimin e kapaciteteve të vendeve përfituese për të zbatuar Traktatin;

ii të marrë parasysh prioritetet dhe nevojat specifike të vendeve që marrin ndihmë për t'u mundësuar përdoruesve që të përfitojnë plotësisht nga dispozitat e Traktatit.

2. *[Asistenca teknike dhe ngritja e kapaciteteve]* a) Aktivitetet e asistencës teknike dhe ngritjes së kapaciteteve të ofruara sipas këtij Traktati, do të jenë për zbatimin e këtij Traktati dhe, kur kërkohet, përfshijnë asistencë për:

i. krijimin e kuadrit ligjor të nevojshëm dhe rishikimin e praktikave dhe procedurave administrative të autoriteteve të regjistrimit të disenjove;

ii. ngritja e kapaciteteve të nevojshme të zyrave, duke përfshirë por pa u kufizuar në ofrimin e trajnimeve për burimet njerëzore, mbështetjen teknologjike dhe rritjen e ndërgjegjësimit;

b) Organizata kërkohet të ofrojë, në përputhje me rregullat dhe rregulloret financiare të WIPO-s, financim për asistencën teknike dhe ndërtimin e kapacitetit për zbatimin e Konventës, në përputhje me paragrafët 1, 2 “a”, 3 “a” dhe nenin 26/1 “c” dhe 26/2 “vi”. Gjithashtu, Organizata inkurajohet të lidhë marrëveshje me organizata ndërkombëtare financiare, organizata ndërqeveritare dhe qeveritë e vendeve marrëse për të ofruar mbështetje financiare për asistencën teknike sipas këtij Traktati.

3. *[Dispozita të tjera]* a) Palët kontraktuese inkurajohen të marrin pjesë në bibliotekat digjitale të Organizatës për disenjot e regjistruara, për të cilat Byroja Ndërkombëtare do të mundësojë aksesin. Palët kontraktuese inkurajohen, gjithashtu, të komunikojnë informacionin e publikuar për disenjot e regjistruara nëpërmjet këtyre sistemeve. Byroja Ndërkombëtare do të mbështesë palët kontraktuese në përpjekjet e tyre për të shkëmbyer informacion nëpërmjet këtyre sistemeve. Byroja Ndërkombëtare kërkohet të mundësojë aksesin në bibliotekat digjitale përkatëse të zyrave;

b) Palët kontraktuese të këtij Traktati mund të krijojnë një sistem reduktimi të tarifave në interes të aplikantëve.

Neni 25 **Rregulloret**

1. *[Përmbajtja]* a) Rregulloret e bashkëlidhura këtij Traktati parashikojnë rregulla, në lidhje me:

i. çështjet që ky Traktat parashikon shprehimisht të rregullohen me rregullore;

ii. çdo detaj të dobishëm në zbatimin e dispozitave të këtij Traktati;

iii. çdo kërkesë, çështje apo procedurë administrative;

b) Rregulloret parashikojnë, gjithashtu, botimin e Formularëve Model Ndërkombëtar që do të vendosen nga Asambleja.

2. *[Ndryshimi i rregullores]* Në bazë të paragrafit 3, çdo ndryshim i rregullores do të kërkojë tre të katërtat e votave të hedhura.

3. *[Kërkesa për unanimitetin]* a) Rregulloret mund të specifikojnë dispozita të rregulloreve të cilat mund të ndryshohen vetëm me unanimitet.

b) Çdo ndryshim i rregulloreve që rezulton në shtimin e dispozitave ose fshirjen e dispozitave nga ato të specifikuara në rregullore, në përputhje me nënparagrafin “a”, do të kërkojë unanimitet;

c) Në përcaktimin nëse arrihet unanimiteti, do të merren parasysh vetëm votat e hedhura. Abstenimet nuk do të konsiderohen si vota.

4. *[Konflikti ndërmjet Traktatit dhe rregulloreve]* Në rast konflikti midis dispozitave të këtij Traktati dhe atyre të rregullores, këto të parat do të kenë përparësi.

Neni 26 **Asambleja**

1. *[Përbërja]* a) Palët kontraktuese do të kenë një Asamble;

b) Çdo palë kontraktuese do të përfaqësohet në Asamble nga një delegat, i cili mund të asistohet nga delegatë, këshilltarë dhe ekspertë alternativë. Çdo delegat mund të përfaqësojë vetëm një palë kontraktuese;

c) Shpenzimet e secilit delegacion do të mbulohen nga pala kontraktuese që ka caktuar delegimin. Asambleja mund t’i kërkojë Organizatës të japë ndihmë financiare për të lehtësuar pjesëmarrjen e delegacioneve të palëve kontraktuese që konsiderohen si vende në zhvillim, në përputhje me

praktikën e vendosur të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara ose vendeve më pak të zhvilluara ose që janë vende në tranzicion drejt një ekonomie tregu.

2. *[Detyrat]* Asambleja do:

i. të trajtojë çështjet në lidhje me zhvillimin/hartimin e këtij Traktati;

ii. të krijojë Formularë Model Ndërkombëtarë, të përmendura në nenin 25/1 “b”;

iii. të ndryshojë rregulloret;

iv. të përcaktojë kushtet për datën e zbatimit të çdo ndryshimi të përmendur në pikën “iii”;

v. të monitorojë, në çdo seancë të zakonshme, asistencën teknike të dhënë për zbatimin e këtij Traktati;

vi. t’i kërkojë Byrosë Ndërkombëtare, me synimin për të lehtësuar zbatimin e këtij Traktati, që të ofrojë asistencë teknike, veçanërisht për vendet në zhvillim dhe vendet më pak të zhvilluara, në përputhje me nenin 24;

vii. kryen funksione të tjera që janë të përshtatshme për zbatimin e dispozitave të këtij Traktati.

3. *[Kuorumi]* a) Gjysma e anëtarëve të Asamblesë që janë shtete, do të përbëjnë një kuorum;

b) Pavarësisht nga nënparagrafi “a”, nëse, në çdo seancë, numri i anëtarëve të Asamblesë që janë shtete dhe janë të përfaqësuar është më pak se gjysma, por i barabartë ose më shumë se një e treta e anëtarëve të Asamblesë që janë shtete, Asambleja mund të marrë vendime, por, me përjashtim të vendimeve në lidhje me procedurën e saj, të gjitha vendimet e tilla do të hyjnë në fuqi vetëm nëse plotësohen kushtet e përcaktuara më poshtë. Byroja Ndërkombëtare do t’ua komunikojë vendimet e përmendura anëtarëve të Asamblesë që janë shtete dhe nuk ishin përfaqësuar dhe i fton ata të shprehin me shkrim votën ose abstenimin e tyre brenda një periudhe tremujore nga data e komunikimit. Nëse, në përfundimin e kësaj periudhe, numri i atyre anëtarëve që kanë shprehur në këtë mënyrë votën ose abstenimin, arrin numrin e anëtarëve që mungonin për arritjen e kuoromit seancën përkatëse, këto vendime do të hyjnë në fuqi, me kusht që në të njëjtën kohë të vazhdojë të jetë e nevojshme shumica e kërkuar.

4. *[Marrja e vendimeve në Asamble]* a) Asambleja do të përpiqet të marrë vendimet e saj me konsensus;

b) Kur një vendim nuk mund të merret me konsensus, çështja në fjalë do të vendoset me votim. Në një rast të tillë:

i. secila palë kontraktuese që është shtet, do të ketë një votë dhe do të votojë vetëm në emrin e saj; dhe

ii. çdo palë kontraktuese që është organizatë ndërqeveritare mund të marrë pjesë në votim, në vend të shteteve anëtare të saj, me një numër votash të barabartë me numrin e shteteve anëtare të saj të cilat janë palë në këtë Traktat. Asnjë organizatë e tillë ndërqeveritare nuk do të marrë pjesë në votim nëse ndonjë nga shtetet e saj anëtare ushtron të drejtën e votës dhe *anasjelltas*. Përveç kësaj, asnjë organizatë e tillë ndërqeveritare nuk do të marrë pjesë në votim nëse ndonjë nga shtetet e saj anëtare palë në këtë Traktat është një shtet anëtar i një organizate tjetër të tillë ndërqeveritare dhe kjo organizatë tjetër ndërqeveritare merr pjesë në atë votim.

5. *[Shumica]* a) Në bazë të nenit 25/2 dhe 3, vendimet e Kuvendit do të kërkojnë dy të tretat e votave të hedhura;

b) Në përcaktimin nëse është arritur shumica e kërkuar, vetëm votat e hedhura do të merren parasysh. Abstenimet nuk do të konsiderohen si vota.

6. *[Seancat]* Asambleja do të mbledhet me thirrjen e drejtorit të përgjithshëm dhe, në mungesë të rrethanave të jashtëzakonshme, gjatë të njëjtës periudhë dhe në të njëjtin vend si Asambleja e Përgjithshme e Organizatës.

7. *[Rregullorja e punës]* Asambleja vendos rregulloren e vet të punës, duke përfshirë rregullat për thirrjen e seancave të jashtëzakonshme.

Neni 27

Byroja Ndërkombëtare

1. *[Detyrat Administrative]* a) Byroja Ndërkombëtare do të kryejë detyrat administrative në lidhje me këtë Traktat;

b) Në veçanti, Byroja Ndërkombëtare do të përgatisë takimet dhe do të sigurojë Sekretariatin e Asamblesë dhe të komisioneve të ekspertëve dhe grupeve të punës që mund të krijohen nga Asambleja.

2. *[Takime të tjera përveç seancave të Asamblesë]* Drejtori i përgjithshëm thërret çdo komision dhe grup pune të krijuar nga Asambleja.

3. *[Roli i Byrosë Ndërkombëtare në Asamble dhe takime të tjera]* a) Drejtori i përgjithshëm dhe personat e caktuar nga drejtori i përgjithshëm do të marrin pjesë, pa të drejtë vote, në të gjitha mbledhjet e Asamblesë, komisionet dhe grupet e punës të krijuara nga Asambleja;

b) Drejtori i përgjithshëm ose një anëtar personeli i caktuar nga drejtori i përgjithshëm, do të jetë Sekretari i Asamblesë dhe i komiteteve dhe grupeve të punës të përmendura në nënparagrafin “a”.

4. *[Konferencat]* a) Byroja Ndërkombëtare, në përputhje me udhëzimet e Asamblesë, do të bëjë përgatitjet për çdo konferencë rishikimi;

b) Byroja Ndërkombëtare mund të konsultohet me shtetet anëtare të Organizatës, organizatat ndërqeveritare dhe organizatat joqeveritare ndërkombëtare dhe kombëtare në lidhje me përgatitjet në fjalë;

c) Drejtori i përgjithshëm dhe personat e caktuar nga drejtori i përgjithshëm do të marrin pjesë, pa të drejtë vote, në diskutimet në konferencat e rishikimit.

5. *[Detyra të tjera]* Byroja Ndërkombëtare do të kryejë çdo detyrë tjetër që i është caktuar në lidhje me këtë Traktat.

Neni 28

Rishikimi

Ky Traktat mund të rishikohet vetëm nga një konferencë diplomatike. Thirrja e çdo konference diplomatike vendoset nga Asambleja.

Neni 29

Bërja palë e Traktatit

1. *[Përshtatshmëria]* Subjektet e mëposhtme mund të nënshkruajnë dhe, në bazë të paragrafëve 2 dhe 3, dhe nenit 30/1 dhe 3, të bëhen palë në këtë Traktat:

i. çdo shtet anëtar i Organizatës, në lidhje me të cilin disenjot industriale mund të regjistrohen ose patentohen në zyrën e tij;

ii. çdo organizatë ndërqeveritare që mban një zyrë në të cilën disenjot industriale mund të regjistrohen me efekt në territorin në të cilin zbatohet traktati themelues i organizatës ndërqeveritare, në të gjitha shtetet e saj anëtare ose në ato të shteteve të saj anëtare që janë caktuar për këtë qëllim në aplikimin përkatës, me kusht që të gjitha shtetet anëtare të organizatës ndërqeveritare të jenë anëtarë të Organizatës;

iii. çdo shtet anëtar i Organizatës, në lidhje me të cilin disenjot industriale mund të regjistrohen vetëm nëpërmjet zyrës së një shteti tjetër të specifikuar që është anëtar i Organizatës;

iv. çdo shtet anëtar i Organizatës, në lidhje me të cilin disenjot industriale mund të regjistrohen vetëm nëpërmjet zyrës së mbajtur nga një organizatë ndërqeveritare, anëtar i së cilës është ai shtet;

v. çdo shtet anëtar i Organizatës, në lidhje me të cilin disenjot industriale mund të regjistrohen vetëm nëpërmjet një zyre të përbashkët për një grup shtetesh anëtare të Organizatës.

2. *[Ratifikimi ose Aderimi]* Çdo subjekt i përmendur në paragrafin 1 mund të depozitojë:

i. një instrument ratifikimi, nëse ka nënshkruar këtë Traktat;

ii. një instrument aderimi, nëse nuk e ka nënshkruar këtë Traktat.

3. *[Data kur depozitimi hyn në fuqi]* Data kur depozitimi i një instrumenti ratifikimi ose aderimi hyn në fuqi do të jetë:

- i. në rastin e një shteti të përmendur në paragrafin 1 “i”, data në të cilën instrumenti i atij shteti është depozituar;
- ii. në rastin e një organizate ndërqeveritare, data në të cilën është depozituar instrumenti i asaj organizate ndërqeveritare;
- iii. në rastin e një shteti të përmendur në paragrafin 1 “iii”, data kur përmbushet kushti i mëposhtëm: instrumenti i atij shteti është depozituar dhe instrumenti i shtetit tjetër të specifikuar është depozituar;
- iv. në rastin e një shteti të përmendur në paragrafin 1 “iv”, data e zbatuar sipas pikës “ii”, më sipër;
- v. në rastin e një shteti anëtar të një grupi shtetesh të përmendur në paragrafin 1 “v”, data në të cilën janë depozituar instrumentet e të gjitha shteteve anëtare të grupit.

Neni 30

Hyrja në fuqi; data e hyrjes në fuqi e ratifikimit dhe aderimit

1. *[Instrumentet që duhen marrë në konsideratë]* Për qëllime të këtij neni, vetëm instrumentet e ratifikimit ose aderimit që janë depozituar nga subjektet e përmendura në nenin 29/1 dhe që kanë një datë efektive sipas nenit 29/3 do të merren parasysh.
2. *[Hyrja në fuqi e Traktatit]* Ky Traktat do të hyjë në fuqi tre muaj pasi 15 shtetet ose organizatat ndërqeveritare të përmendura në nenin 29/1 “ii”, të kenë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit ose aderimit.
3. *[Hyrja në fuqi e ratifikimit dhe aderimeve pas hyrjes në fuqi të traktatit]* Çdo subjekt që nuk mbulohet nga paragrafi 2, do të jetë i detyruar ligjërisht nga ky Traktat tre muaj pas datës në të cilën ka depozituar instrumentin e tij të ratifikimit ose aderimit.

Neni 31

Rezervat

1. *[Rezerva mbi nenin 5/2 “b”]* Çdo shtet ose organizatë ndërqeveritare mund të shpallë, përmes një rezerve, se pavarësisht nenit 5/2 “b”, ligji i saj i zbatueshëm në momentin që bëhet pjesë e kësaj Konvente, nuk lejon që aplikanti ose një person tjetër i interesuar, i cili nuk ka asnjë vendbanim apo ndërmarrje industriale ose tregtare të vërtetë dhe efektive në territorin e atij shteti, ose organizate ndërqeveritare, të veprojnë për veten e tij/saj para zyrës për regjistrimin e një aplikimi, për qëllim të datës së regjistrimit.
2. *[Rezerva mbi nenet 7, 10/1, 16/2 dhe/ose 19/2]* Çdo shtet ose organizatë ndërqeveritare, ligji i zbatueshëm i së cilës në momentin që bëhet pjesë e këtij Traktati nuk është në përputhje me nenet 7, 10/1, 16/2 dhe/ose 19/2, mund të shpallë përmes një rezerve, se nuk do të jetë e detyruar ligjërisht nga nenet 7, 10/1, 16/2 dhe/ose 19/2).
3. *[Modalitetet]* Çdo rezervë në përputhje me paragrafët 1 ose 2 duhet të bëhet nëpërmjet një deklarate që shoqëron instrumentin e ratifikimit ose aderimit në këtë Traktat nga shteti ose organizata ndërqeveritare që bën rezervën.
4. *[Tërheqja]* Çdo rezervë sipas paragrafëve 1 ose 2 mund të tërhiqet në çdo kohë.
5. *[Ndalimi i rezervave të tjera]* Nuk do të lejohet asnjë rezervë për këtë Traktat përveç rezervave të lejuara sipas paragrafëve 1 ose 2.

Neni 32

Prishja e marrëveshjes me Traktatin

1. *[Njoftimi]* Çdo palë kontraktuese mund të denoncojë këtë Traktat dhe të mos jetë më i detyruar nga kushtet e këtij Traktati me anë të një njoftimi drejtuar drejtorit të përgjithshëm.

2. *[Data e hyrjes në fuqi]* Prishja e marrëveshjes me Traktatin do të hyjë në fuqi një vit nga data në të cilën drejtori i përgjithshëm ka marrë njoftimin. Kjo nuk do të ndikojë në zbatimin e këtij Traktati për çdo aplikim në pritje ose për disenjo industriale të regjistruara në lidhje me palën kontraktuese denoncuese, deri në kohën e përfundimit të periudhës njëvjeçare në fjalë, me kusht që pala kontraktuese, pas përfundimit të periudhës së përmendur njëvjeçare, të ndërpresë zbatimin e këtij Traktati për çdo regjistrim, duke filluar nga data kur ky regjistrim është përcaktuar për rinovim.

Neni 33

Gjuhët e Traktatit; nënshkrimi

1. *[Tekste origjinale; tekste zyrtare]* a) Ky Traktat do të nënshkruhet në një origjinal të vetëm në gjuhët angleze, arabe, kineze, frënge, ruse dhe spanjolle, ku të gjitha tekstet janë njëlloj autentike;

b) Një tekst zyrtar në një gjuhë që nuk përmendet në nënparagrafin “a” që është gjuhë zyrtare e një pale kontraktuese, do të hartohet nga drejtori i përgjithshëm pas konsultimit me palën kontraktuese në fjalë dhe çdo palë tjetër kontraktuese të interesuar.

2. *[Afati kohor për nënshkrim]* Ky Traktat do të mbetet i hapur për nënshkrim në selinë e Organizatës për një vit pas miratimit të tij.

Neni 34

Depozitari

Drejtori i përgjithshëm do të jetë depozitari i këtij Traktati.

RREGULLORET SIPAS TRAKTATIT TË RIADIT PËR DISENJOT

Rregulli 1 Shprehjet e shkurtuara

Rregulli 2 Detajet në lidhje me aplikimin

Rregulli 3 Detajet në lidhje me paraqitjen e disenjës industriale

Rregulli 4 Detajet në lidhje me përfaqësuesit, adresën për dorëzimin ose adresën për korrespondencë

Rregulli 5 Detajet në lidhje me datën e paraqitjes së aplikimit

Rregulli 6 Detajet në lidhje me publikimin

Rregulli 7 Detajet në lidhje me komunikimet

Rregulli 8 Identifikimi i një aplikimi pa numrin e tij të aplikimit

Rregulli 9 Detajet në lidhje me rinovimin

Rregulli 10 Detajet në lidhje me lehtësitë për afatet kohore

Rregulli 11 Detajet në lidhje me rivendosjen e të drejtave pas një konstatimi nga Zyra për Kujdes të Duhur ose Pavullnetshmëri, sipas nenit 15

Rregulli 12 Detajet në lidhje me korrigjimin ose shtimin e kërkesës për prioritet dhe rivendosjen e të drejtës së prioritetit, sipas nenit 16

Rregulli 13 Detajet në lidhje me kërkesat për regjistrimin e një licence ose interesi garancie, ose për ndryshimin, ose anulimin e regjistrimit të një licence, ose interesi garancie

Rregulli 14 Detajet në lidhje me kërkesën për regjistrimin e një ndryshimi në pronësi

Rregulli 15 Detajet në lidhje me kërkesën për regjistrimin e një ndryshimi në emër ose adresë

Rregulli 16 Detajet në lidhje me kërkesën për korrigjimin e një gabimi

Rregulli 17 Formulari Model Ndërkombëtar

Rregulli 18 Kërkesa për unanimitet sipas nenit 25/3 “a”

RREGULLI 1

SHPREHJET E SHKURTUARA

1. *[Shprehjet e shkurtuara të përcaktuara në rregullore]* Për qëllimet e kësaj rregulloreje, përveç rasteve kur shprehimisht përcaktohet ndryshe:

- i. “Traktati” nënkupton Traktatin e Riadit për Disenjt;
 - ii. “Nen” i referohet nenit të specifikuar të Traktatit;
 - iii. “Klasifikimi i Lokarnos” nënkupton klasifikimin e vendosur nga Marrëveshja e Lokarnos që përcakton një klasifikim ndërkombëtar për disenjt industriale, të nënshkruar në Lokarno, më 8 tetor 1968, të rishikuar dhe ndryshuar;
 - iv. “Licencë ekskluzive” nënkupton një licencë që i jepet vetëm një të licencuari dhe që e përjashton mbajtësin nga përdorimi i disenjos industriale dhe nga dhënia e licencave për çdo person tjetër;
 - v. “Licencë e vetme” nënkupton një licencë e cila i jepet vetëm një të licencuari dhe e përjashton mbajtësin nga dhënia e licencave për çdo person tjetër, por nuk e përjashton mbajtësin nga përdorimi i disenjos industriale;
 - vi. “Licencë joekskluzive” nënkupton licencën e cila nuk e përjashton mbajtësin nga përdorimi i disenjos industriale ose nga dhënia e licencave për ndonjë person tjetër.
2. *[Shprehjet e shkurtuara të përcaktuara në Traktat]* Shprehjet e shkurtuara të përcaktuara në nenin 1 për qëllimet e Traktatit, do të kenë të njëjtin kuptim për qëllimet e kësaj rregulloreje.

RREGULLI 2

DETAJE NË LIDHJE ME APLIKIMIN

1. *[Kërkesa të tjera sipas nenit 4]* Përveç kërkesave të parashikuara në nenin 4, një palë kontraktuese mund të kërkojë që një aplikim të përmbajë disa ose të gjithë treguesit ose elementet e mëposhtme:

- i. një tregues për klasën e klasifikimit të Lokarnos së cilës i përket produkti që përfshin disenjon industriale ose në lidhje me të cilin do të përdoret disenjoja industriale;
- ii. një kërkesë;
- iii. një deklaratë për risinë;
- iv. një përshkrim;
- v. të dhënat në lidhje me identitetin e krijuesit të disenjos industriale;
- vi. një deklaratë që krijuesi çmon se është vetë ai krijuesi i disenjos industriale;
- vii. kur aplikanti nuk është krijuesi i disenjos industriale, një deklaratë e caktimit ose, sipas dëshirës së aplikantit, prova të tjera të transferimit të disenjos tek aplikanti i pranuar nga zyra;
- viii. kur aplikanti është person juridik, natyrën juridike të atij personi juridik dhe shtetit, dhe kur është e zbatueshme, njësinë territoriale brenda atij shteti, sipas ligjit të të cilit është organizuar ky person juridik;
- ix. emrin e një shteti të cilit aplikanti i përket si shtetas, nëse ai/ajo është shtetas i ndonjë shteti, emri i një shteti në të cilin aplikanti ka vendbanimin e tij/saj, nëse ka, dhe emrin e një shteti në të cilin aplikanti ka një ndërmarrje reale dhe efektive industriale ose tregtare, nëse ka;
- x. një tregues të çdo aplikimi ose regjistrimi paraprak, ose informacion tjetër për të cilin aplikanti është në dijeni, i cili mund të ketë ndikim në pranueshmërinë për regjistrimin e disenjos industriale;
- xi. kur aplikanti dëshiron të mbajë disenjon industriale të papublikuar për një periudhë kohore, një kërkesë për këtë qëllim;
- xii. kur aplikimi përfshin më shumë se një disenjo industriale, një tregues për numrin e disenjove industriale të përfshira;
- xiii. një tregues të afatit të mbrojtjes për të cilën është paraqitur kërkesa;
- xiv. kur një palë kontraktuese kërkon pagesën e një tarife në lidhje me një aplikim, provat se pagesa është kryer;
- xv. kur është e zbatueshme, një tregues të disenjos së pjeshme;
- xvi. kur është e zbatueshme, një kërkesë për publikim të mëparshëm.

2. *[Kërkesat në rastin e aplikimeve të ndara]* Një palë kontraktuese mund të kërkojë që, kur një aplikim duhet të trajtohet si një aplikim i ndarë, aplikimi të përmbajë sa vijon:

- i. një tregues për këtë qëllim;
- ii. numrin dhe datën e depozitimit të aplikimit fillestar.

3. *[Disenjoja e pjesshme]* Një palë kontraktuese, nëse ligji i zbatueshëm e lejon, do të lejojë që aplikimi të kryhet ndaj një disenjoje të përfshirë në një pjesë të një artikulli ose produkti.

RREGULLI 3

DETAJET NË LIDHJE ME PARAQITJEN E DISENJOS INDUSTRIALE

1. *[Forma e paraqitjes së disenjos industriale]* a) Paraqitja e disenjos industriale, sipas dëshirës së aplikantit, do të jetë në formën e:

- i. fotografive;
- ii. riprodhimeve grafike;
- iii. çdo paraqitjeje tjetër vizuale të pranuar nga zyra;
- iv. një kombinim të ndonjë prej formave të mësipërme, aty ku lejohet sipas ligjit në fuqi;

b) Paraqitja e disenjos industriale, sipas dëshirës së aplikantit, mund të jetë me ngjyra ose bardh e zi;

c) Disenjoja industriale do të paraqitet si element i vetëm, me përjashtim të çdo përmbajtjeje tjetër.

2. *[Të dhënat në lidhje me paraqitjen]* Pavarësisht nga paragrafi 1 “c”, paraqitja e disenjos industriale mund të përfshijë:

i. përmbajtje që nuk bëjnë pjesë në disenjon e pretenduar, nëse ajo tregohet me mjete vizuale siç janë vijat me pika ose të thyera dhe/ose, nëse lejohet nga ligji përkatës, identifikohen si të tilla në përshkrim;

ii. hijezim, për të treguar konturet ose vëllimin e një disenjoje tredimensionale.

3. *[Pikëpamjet]* a) Disenjo industriale, sipas zgjedhjes së aplikantit, mund të paraqitet nga një pikëpamje që zbulon plotësisht disenjon industriale ose nga disa pikëpamje të ndryshme që zbulojnë plotësisht disenjon industriale;

b) Pavarësisht nga nënparagrafi “a”, mund të kërkohen nga zyra pamje shtesë, të veçanta, kur këto pamje janë të nevojshme për të treguar plotësisht produktin ose produktet që përfshijnë disenjon industriale ose në lidhje me të cilat do të përdoret disenjoja industriale. Megjithatë, pamjet shtesë që zbulojnë përmbajtje të reja që ndikojnë në disenjon industriale, të cilat nuk janë të nxjerra nga pikëpamja ose pikëpamjet origjinale, nuk duhet të pranohen.

4. *[Numri i kopjeve të paraqitjes]* Nuk mund të kërkohet më shumë se një kopje për çdo paraqitje të disenjos industriale kur aplikimi është dorëzuar në mënyrë elektronike dhe jo më shumë se tre kopje kur aplikimi është dorëzuar në letër.

Rregulli 4

Detajet në lidhje me përfaqësuesit, adresën për dorëzim ose adresën për korrespondencë

1. *[Caktimi i përfaqësuesit sipas nenit 5/4; prokura]* a) Kurdoherë që një palë kontraktuese lejon ose kërkon që një aplikant, mbajtës ose person tjetër i interesuar të përfaqësohet nga një përfaqësues përpara zyrës, ajo mund të kërkojë që përfaqësuesi të caktohet në një komunikim të veçantë (në vijim: “prokurë”), duke treguar emrin e aplikantit, mbajtësit ose personit tjetër të interesuar, sipas rastit, si dhe emrin dhe adresën e përfaqësuesit;

b) Prokura mund të lidhet me një ose më shumë aplikime dhe/ose regjistrime të identifikuara në prokurë ose, me ndonjë përjashtim të treguar nga personi që emëron, me të gjitha aplikimet dhe/ose regjistrimet ekzistuese dhe të ardhshme të atij personi;

c) Prokura mund të kufizojë kompetencat e përfaqësuesit në disa akte. Një palë kontraktuese mund të kërkojë që çdo prokurë, sipas të cilës përfaqësuesi ka të drejtë të tërheqë një aplikim ose të dorëzojë një regjistrim, të përmbajë një tregues të shprehur për këtë qëllim.

2. *[Afati kohor sipas nenit 5/6]* Afati kohor i përmendur në nenin 5/6 do të jetë jo më pak sesa një muaj nga data e njoftimit të përmendur në atë nen, në rastet kur adresa e aplikantit, mbajtësit ose personit tjetër të interesuar ndodhet në territorin e palës kontraktuese që bën njoftimin dhe jo më pak se dy muaj nga data e njoftimit kur një adresë e tillë është jashtë territorit të asaj pale kontraktuese.

3. *[Provat]* Një palë kontraktuese mund të kërkojë që të depozitohen prova në zyrë kur zyra mund të dyshojë në mënyrë të arsyeshme vërtetësinë e ndonjë treguesi të përfshirë në komunikimet e përmendura në paragrafin 1.

RREGULLI 5 DETAJET NË LIDHJE ME DATËN E DEPOZITIMIT

Afati kohor i përmendur në nenin 6/4 do të jetë jo më pak sesa një muaj nga data e njoftimit të përmendur në atë nen.

RREGULLI 6 DETAJET NË LIDHJE ME PUBLIKIMIN

Periudha minimale e përmendur në nenin 10/1, do të jetë gjashtë muaj nga data e depozitimit.

RREGULLI 7 DETAJET NË LIDHJE ME KOMUNIKIMET

1. *[Detajet në lidhje me nenin 12/3]* a) Një palë kontraktuese mund të kërkojë që adresa për korrespondencën e përmendur në nenin 12/3 “i” dhe adresa e dorëzimit e përmendur në nenin 12/3 “ii”, të jetë në një territor të përcaktuar nga ajo palë kontraktuese.

b) Një palë kontraktuese mund të kërkojë që aplikanti, mbajtësi ose personi tjetër i interesuar të përfshijë disa ose të gjithë të dhënat e kontaktit të mëposhtme në çdo komunikim:

- i. numër telefoni;
- ii. numër telefaksimileje;
- iii. adresë *email*-i.

2. *[Treguesit Shoqërues të Nënshkrimit të Komunikimit në Letër]* Një palë kontraktuese mund të kërkojë që nënshkrimi i personit fizik të shoqërohet nga:

i. një tregues, me shkronja të emrit kryesor dhe mbiemrit të familjes dhe të emrit ose emrave të dhënë ose dytësorë të atij personi ose, sipas dëshirës së tij, të emrit ose emrave të përdorur zakonisht nga personi në fjalë;

ii. një tregues për cilësinë në të cilën ai person ka nënshkruar, kur një cilësi e tillë nuk është e dukshme nga leximi i komunikimit.

3. *[Data e nënshkrimit]* Një palë kontraktuese mund të kërkojë që një nënshkrim të shoqërohet me një tregues të datës në të cilën është kryer nënshkrimi. Kur ky tregues kërkohet por nuk jepet, data e nënshkrimit do të konsiderohet të jetë data në të cilën është marrë nga zyra komunikimi që mban nënshkrimin ose, nëse pala kontraktuese e lejon këtë, një datë më e hershme se data e fundit.

4. *[Nënshkrimi i komunikimeve në letër]* Kur një komunikim me zyrën e një pale kontraktuese është në letër dhe kërkohet një nënshkrim, ajo palë kontraktuese:

- i. sipas pikës “iii”, do të pranojë një nënshkrim të shkruar me dorë;
- ii. mund të lejojë, në vend të një nënshkrimi të shkruar me dorë, përdorimin e formave të tjera të nënshkrimit, të tilla si një nënshkrim i printuar ose i stampuar, ose përdorimin e një vule ose etikete me barkod;
- iii. kur personi fizik që nënshkruan komunikimin është shtetas i palës kontraktuese në fjalë dhe adresa e këtij personi ndodhet në territorin e saj ose kur personi juridik në emër të të cilit është nënshkruar komunikimi, është i organizuar sipas ligjit të saj dhe ka ose një vendbanim ose një ndërmarrje reale dhe efektive industriale ose tregtare në territorin e saj, mund të kërkojë që të përdoret një vulë në vend të një nënshkrimi të shkruar me dorë.

5. *[Vërtetimi, noterizimi, autentifikimi, legalizimi ose vërtetimi tjetër i nënshkrimit të komunikimeve në letër]* Një palë kontraktuese mund të kërkojë vërtetimin, noterizimin, autentifikimin, legalizimin ose vërtetim tjetër të çdo nënshkrimi të një komunikimi në letër, sipas nenit 12/4 “b”, nëse komunikimi lidhet me tërheqjen e një aplikimi ose dorëzimin e një regjistrimi.

6. *[Nënshkrimi i komunikimeve në letër të dorëzuara me mjete elektronike transmetimi]* Një palë kontraktuese që parashikon që komunikimet në letër të depozitohen me mjete elektronike transmetimi, do të konsiderojë çdo komunikim të tillë të nënshkruar nëse një paraqitje grafike ose tjetër e një nënshkrimi të pranuar nga ajo palë kontraktuese sipas paragrafit 4, shfaqet në komunikim siç është marrë.

7. *[Origjinali i një komunikimi në letër të dorëzuar me mjete elektronike të transmetimit]* Një palë kontraktuese që parashikon që komunikimet në letër të dorëzohen me mjete elektronike të transmetimit, mund të kërkojë që origjinali i çdo komunikimi të tillë të depozitohet në zyrë:

- i. shoqëruar me një letër që identifikon atë transmetim të mëparshëm; dhe
- ii. brenda një afati kohor i cili do të jetë të paktën një muaj nga data në të cilën zyra ka marrë komunikimin me mjete elektronike transmetimi.

8. *[Vërtetimi i komunikimeve në formë elektronike]* Një palë kontraktuese që lejon paraqitjen e komunikimeve në formë elektronike, mund të kërkojë që çdo komunikim i tillë të vërtetohet nëpërmjet një sistemi të vërtetimit elektronik, siç përcaktohet nga ajo palë kontraktuese.

9. *[Data e marrjes]* Një palë kontraktuese do të jetë e lirë që të përcaktojë rrethanat në të cilat marrja e një dokumenti ose pagesa e një tarife do të konsiderohet se përbën marrje nga zyra ose pagesë ndaj saj në rastet kur dokumenti është marrë realisht, ose pagesa është kryer realisht për:

- i. një degë ose nënzyrë të Zyrës;
- ii. një zyrë kombëtare në emër të zyrës së palës kontraktuese, ku pala kontraktuese është një organizatë ndërqeveritare;
- iii. një shërbim postar zyrtar;
- iv. një shërbim shpërndarjeje ose një agjenci, të specifikuar nga pala kontraktuese;
- v. një adresë të ndryshme nga adresat e caktuara të Zyrës.

10. *[Dosja elektronike]* Në bazë të paragrafit 9, kur një palë kontraktuese parashikon paraqitjen e një komunikimi në formë elektronike ose me mjete elektronike të transmetimit dhe komunikimi është paraqitur në këtë mënyrë, data në të cilën zyra e asaj pale kontraktuese merr komunikimin në këtë formë ose me mjete të tilla, do të përbëjë datën e marrjes së komunikimit.

11. *[Treguesit sipas nenit 12/7]* a) Një palë kontraktuese mund të kërkojë që në çdo komunikim:

- i. të tregojë emrin dhe adresën e aplikantit, mbajtësit ose personit tjetër të interesuar;
- ii. të tregojë numrin e aplikimit ose regjistrimit me të cilin lidhet;
- iii. të përmbajë numrin ose tregues tjetër në të cilin ai/ajo është i regjistruar ku aplikanti, mbajtësi ose personi tjetër i interesuar është i regjistruar në zyrë;
- iv. kur një palë kontraktuese kërkon pagesën e një tarife në lidhje me një procedurë para zyrës, të përmbajë treguesit e nevojshëm për zyrën e palës kontraktuese për të mbledhur tarifën, duke përfshirë shumën e tarifës dhe mënyrën e pagesës së saj;

b) Një palë kontraktuese mund të kërkojë që çdo komunikim nga një përfaqësues për qëllimet e një procedure përpara zyrës, të përmbajë:

- i. emrin dhe adresën e përfaqësuesit;
- ii. një referencë për prokurën në bazë të së cilës vepron përfaqësuesi;
- iii. ku përfaqësuesi është i regjistruar në zyrë, numrin ose treguesin tjetër në të cilin është regjistruar.

RREGULLI 8

IDENTIFIKIMI I NJË APLIKIMI PA NUMRIN E TIJ TË APLIKIMIT

1. *[Mënyra e identifikimit]* Kur kërkohet që një aplikim të identifikohet me numrin e tij të aplikimit, por një numër i tillë ende nuk është lëshuar ose nuk është i njohur për aplikantin ose përfaqësuesin e tij, aplikimi do të konsiderohet i identifikuar nëse jepet sa vijon:

- i. numri i përkohshëm i aplikimit i dhënë nga zyra, nëse ka; ose
- ii. një kopje e aplikimit; ose

iii. një paraqitje e disenjos industriale, e shoqëruar me një tregues të datës në të cilën, në dijeninë më të mirë të aplikantit ose përfaqësuesit, aplikimi është pranuar nga zyra së bashku me çdo numër identifikimi që i është dhënë aplikimit nga aplikanti ose përfaqësuesi.

2. *[Ndalimi i kërkesave të tjera]* Asnjë palë kontraktuese nuk mund të kërkojë që të përmbushen kërkesa të tjera përveç atyre të përmendura në paragrafin 1, në mënyrë që një aplikim të identifikohet kur numri i aplikimit të tij nuk është lëshuar ende ose nuk është i njohur për aplikantin, ose përfaqësuesin e tij.

RREGULLI 9 DETAJET NË LIDHJE ME RINOVIMIN

Për qëllim të nenit 13/2, periudha gjatë së cilës mund të paraqitet çdo kërkesë për rinovim dhe mund të paguhet çdo tarifë për rinovim, do të fillojë të paktën gjashtë muaj përpara datës në të cilën rinovimi është i nevojshëm dhe do të përfundojë në më pak se gjashtë muaj pas kësaj date. Nëse kërkesa për rinovim paraqitet ose tarifa është paguar pas datës në të cilën rinovimi është i nevojshëm, pranimi i kërkesës për rinovim dhe pagesa e tarifës mund të jetë objekt i pagesës së një shtese.

RREGULLI 10 DETAJET NË LIDHJE ME LEHTËSITË NË RESPEKTIMIN E AFATEVE KOHORE

1. *[Kërkesat sipas nenit 14/1]* a) Një palë kontraktuese mund të kërkojë që një kërkesë e përmendur në nenin 14/1:

- i. të nënshkruhet nga aplikanti ose mbajtësi;
- ii. të përmbajë një tregues që tregon se kërkohet një zgjatje e afatit kohor dhe identifikim i afatit kohor në fjalë;

b) Kur një kërkesë për zgjatje të afatit paraqitet pas përfundimit të afatit, pala kontraktuese mund të kërkojë që të gjitha kërkesat për veprimin në lidhje me të cilin afati kohor zbatohet, të përmbushen në të njëjtën kohë me paraqitjen e kërkesës.

2. *[Periudha dhe afati kohor sipas nenit 14/1]* a) Periudha e zgjatjes së një afati kohor të përmendur në nenin 14/1 do të jetë jo më pak se dy muaj nga data e përfundimit të afatit kohor që nuk është zgjatur;

b) Afati kohor i përmendur në nenin 14/1 “ii” do të përfundojë jo më herët se dy muaj nga data e përfundimit të afatit kohor që nuk është zgjatur.

3. *[Kërkesat sipas nenit 14/2 “i”]* Një palë kontraktuese mund të kërkojë që një kërkesë e përmendur në nenin 14/2 “i”:

- i. të nënshkruhet nga aplikanti ose mbajtësi;
- ii. përmbajnë një tregues që tregon se kërkohet lehtësim në lidhje me mosrespektimin e një afati, si dhe identifikimin e afatit në fjalë.

4. *[Afati kohor për paraqitjen e një kërkesë sipas nenit 14/2 “ii”]* Afati kohor i përmendur në nenin 14/2 “ii” do të përfundojë jo më herët se dy muaj pas një njoftimi nga zyra që aplikanti ose mbajtësi nuk e ka përmbushur afatin e caktuar nga zyra.

5. *[Përgjashtimet sipas nenit 14/3]* Asnjë palë kontraktuese nuk do t’i kërkohet sipas nenit 14/1 ose 2, të japë:

- i. një lehtësim të dytë në lidhje me një afat kohor për të cilin lehtësimi tashmë është dhënë sipas nenit 14/1 ose 2;
- ii. lehtësim për paraqitjen e një kërkesë për masë lehtësuese sipas nenit 14/1 ose 2 ose një kërkesë për rivendosje sipas nenit 15/1;
- iii. lehtësim në lidhje me një afat kohor për pagesën e një tarife rinovimi;
- iv. lehtësim në lidhje me një afat kohor për një veprim përpara një bordi apeli ose organi tjetër shqyrtues të krijuar në kuadër të zyrës;

- v. lehtësim në lidhje me një afat kohor për një veprim në procedurat *inter partes*;
- vi. lehtësim në lidhje me një afat kohor të përmendur në nenin 16/1 ose 2.

RREGULLI 11

DETAJET NË LIDHJE ME RIVENDOSJEN E TË DREJTAVE PAS NJË KONSTATIMI NGA ZYRA PËR KUJDES TË DUHUR OSE PAVULLNETSHMËRI SIPAS NENIT 15

1. [Kërkesat sipas nenit 15/1 “i”] Një palë kontraktuese mund të kërkojë që një kërkesë e përmendur në nenin 15/1 “i” të nënshkruhet nga aplikanti ose mbajtësi.
2. [Afati kohor sipas nenit 15/1 “ii”] Afati kohor për bërjen e një kërkesë dhe përmbushjen e kërkesave sipas nenit 15/1 “ii”, do të jetë më i hershëm për të përfunduar sa vijon:
 - i. jo më pak se dy muaj nga data e eliminimit të shkakut të mosrespektimit të afatit për veprimin në fjalë;
 - ii. jo më pak se 12 muaj nga data e përfundimit të afatit kohor për veprimin në fjalë, ose, kur një kërkesë lidhet me mospagesën e një tarife rinovimi, jo më pak se 12 muaj nga data e përfundimit të periudhës së tolerancës të parashikuar sipas nenit 5 *bis* të Konventës së Parisit.
3. [Përjashtimet sipas nenit 15/2] Përjashtimet e përmendura në nenin 15/2 janë mosrespektimi i një afati kohor:
 - i. për të bërë një kërkesë për lehtësim sipas nenit 14/1 ose 2 ose një kërkesë për rivendosje sipas nenit 15/1;
 - ii. për një veprim para një bordi të ankesave, ose organi tjetër shqyrtues, të krijuar në kuadër të zyrës;
 - iii. për një veprim në procedurë *inter partes*;
 - iv. për paraqitjen e një deklarate e cila, sipas ligjit të palës kontraktuese, mund të vendosë një datë të re depozitimi për një aplikim në pritje;
 - v. të përmendur në nenin 16/1 ose 2.

RREGULLI 12

DETAJET NË LIDHJE ME KORRIGJIMIN OSE SHTIMIN E PRETENDIMIT PËR PRIORITET DHE RIVENDOSJEN E TË DREJTËS SË PRIORITETIT SIPAS NENIT 16

1. [Kërkesat sipas nenit 16/1 “i”] Një palë kontraktuese mund të kërkojë që një kërkesë e përmendur në nenin 16/1 “i”, të nënshkruhet nga aplikanti.
2. [Afati kohor sipas nenit 16/1 “ii”] Afati kohor i përmendur në nenin 16/1 “ii” nuk duhet të jetë më pak sesa gjashtë muaj nga data e prioritetit ose, kur korrigjimi ose shtimi do të shkaktonte një ndryshim në datën e prioritetit, gjashtë muaj nga data e prioritetit të ndryshuar, cilado qoftë periudha gjashtëmujore që përfundon më herët. Pavarësisht nga sa më sipër, një kërkesë e tillë mund të paraqitet deri në përfundimin e dy muajve nga data e depozitimit.
3. [Përjashtim] Asnjë palë kontraktuese nuk do të jetë e detyruar të parashikojë korrigjimin ose shtimin e një pretendimi për prioritet sipas nenit 16/1, nëse kërkesa e përmendur në nenin 16/1 “i” merret pas përfundimit të shqyrtimit bazë të aplikimit.
4. [Afatet kohore sipas nenit 16/2] Afatet kohore të përmendura në nenin 16/2, pjesa hyrëse dhe neni 16/2 “ii” do të përfundojnë jo më pak se një muaj nga data në të cilën përfundon periudha e prioritetit.
5. [Kërkesat sipas nenit 16/2 “i”] Një palë kontraktuese mund të kërkojë që një kërkesë e përmendur në nenin 16/2 “i”:
 - i. të nënshkruhet nga aplikanti; dhe
 - ii. të shoqërohet me kërkesën për prioritet kur aplikimi nuk ka kërkuar prioritetin e aplikimit të mëparshëm.

RREGULLI 13

DETAJET NË LIDHJE ME KËRKESAT PËR REGJISTRIMIN E NJË LICENCE OSE
INTERESI GARANCIE, OSE PËR NDRYSHIMIN OSE ANULIMIN E REGJISTRIMIT TË NJË
LICENCE, OSE INTERESI GARANCIE

1. *[Përmbajtja e kërkesës]* a) Një palë kontraktuese mund të kërkojë që kërkesa për regjistrimin e një licence sipas nenit 17/1 ose 6 të përmbajë disa ose të gjithë treguesit ose elementet e mëposhtme:

- i. emrin dhe adresën e mbajtësit;
- ii. kur mbajtësi ka një përfaqësues, emrin dhe adresën e atij përfaqësuesi;
- iii. kur mbajtësi ka një adresë dorëzimi ose një adresë për korrespondencë, këtë adresë;
- iv. emrin dhe adresën e të licencuarit;
- v. kur i licencuari ka një përfaqësues, emrin dhe adresën e atij përfaqësuesi;
- vi. kur i licencuari ka një adresë dorëzimi ose një adresë për korrespondencë, këtë adresë;
- vii. kur i licencuari është person juridik, natyrën juridike të atij personi juridik dhe shtetin, dhe, kur aplikohet, njësia territoriale brenda atij shteti, sipas ligjit të të cilit është organizuar personi juridik në fjalë;
- viii. emrin e një shteti të cilit i përket si shtetas i licencuari, nëse ai/ajo është shtetas i ndonjë shteti, emrin e një shteti në të cilin i licencuari ka vendbanimin e tij/saj, nëse ka, dhe emrin e një shteti në të cilin i licencuari ka një ndërmarrje reale dhe efektive industriale ose tregtare, nëse ka;
- ix. numrin e regjistrimit të disenjës industriale që është objekt i licencës;
- x. kur licenca nuk është dhënë në lidhje me të gjitha disenjtë industriale të përfshira në një regjistrim, numrin(at) e disenjës industriale për të cilën është dhënë licenca;
- xi. nëse licenca është një licencë ekskluzive, një licencë joekskluzive ose një licencë e vetme;
- xii. sipas rastit, që licenca lidhet vetëm me një pjesë të territorit të mbuluar nga regjistrimi, së bashku me një tregues të qartë të asaj pjese të territorit;
- xiii. kohëzgjatjen e licencës;

b) Një palë kontraktuese mund të kërkojë që kërkesa për ndryshim ose anulim të regjistrimit të një licence, sipas nenit 18/1, të përmbajë disa ose të gjithë treguesit ose elementet e mëposhtëm:

- i. treguesit e specifikuar në pikat “i” deri “ix”, të nënparagrafit “a”;
- ii. natyrën dhe qëllimin e ndryshimit që do të regjistrohet ose një tregues për të cilin anulimi duhet të regjistrohet.

2. *[Dokumentet Mbështetëse për regjistrimin e një licence]* a) Kur licenca është një marrëveshje e lidhur lirisht, një palë kontraktuese mund të kërkojë që kërkesa për regjistrimin e një licence të shoqërohet, sipas dëshirës së palës kërkuuese, me një nga pikat sa vijon:

- i. një kopje të marrëveshjes, kopje e cila mund të kërkohej të vërtetohet, sipas dëshirës së palës kërkuuese, nga një noter publik ose autoritet tjetër publik kompetent, ose, kur lejohet sipas ligjit në fuqi, nga një përfaqësues që ka të drejtë të ushtrojë para zyrës, si konform marrëveshjes origjinale;
- ii. një ekstrakt të marrëveshjes që përbëhet nga ato pjesë të asaj marrëveshjeje që tregojnë palët, si dhe të drejtat e licencuara dhe shtrirjen e tyre, ekstrakti i të cilit mund të kërkohej të vërtetohet, sipas dëshirës së palës kërkuuese, nga një noter publik ose ndonjë autoritet tjetër kompetent, ose, kur lejohet sipas ligjit në fuqi, nga një përfaqësues që ka të drejtë të ushtrojë praktikën pranë zyrës, si një ekstrakt i marrëveshjes i njehsuar me origjinalin;

b) Një palë kontraktuese mund të kërkojë që çdo bashkëmbajtës që nuk është palë në marrëveshjen e licencës, të japë pëlqimin e tij të shprehur për licencën në një dokument të nënshkruar nga ky bashkëmbajtës;

c) Kur licenca nuk është një marrëveshje e lidhur lirisht, për shembull, rezulton nga zbatimi i ligjit ose një vendim gjykatë, një palë kontraktuese mund të kërkojë që kërkesa të shoqërohet me një kopje të një dokumenti që vërteton licencën. Një palë kontraktuese mund të kërkojë, gjithashtu, që kopja të vërtetohet se është në përputhje me dokumentin origjinal, sipas dëshirës së palës kërkuuese, nga autoriteti që ka lëshuar dokumentin ose nga një noter publik, ose autoritet tjetër publik kompetent ose, kur lejohet sipas ligjit në fuqi, nga një përfaqësues që ka të drejtë të ushtrojë praktikën pranë zyrës.

3. *[Dokumentet mbështetëse për ndryshimin e regjistrimit të një licence]* a) Një palë kontraktuese mund të kërkojë që kërkesa për ndryshimin e regjistrimit të një licence të shoqërohet, sipas dëshirës së palës kërkuuese, nga një prej pikave sa vijon:

i. dokumentet që vërtetojnë ndryshimin e kërkuar të regjistrimit të licencës; ose
ii. një deklaratë e pavërtetuar e ndryshimit të licencës, e nënshkruar si nga mbajtësi ashtu edhe nga i licencuari;

b) Një palë kontraktuese mund të kërkojë që çdo bashkëmbajtës që nuk është palë në kontratën e licencës, të japë pëlqimin e shprehur për ndryshimin e licencës në një dokument të nënshkruar nga ky bashkëmbajtës.

4. *[Dokumentet mbështetëse për anulimin e regjistrimit të një licence]* Një palë kontraktuese mund të kërkojë që kërkesa për anulimin e regjistrimit të një licence të shoqërohet, sipas dëshirës së palës kërkuuese, me një nga sa vijon:

i. dokumentet që vërtetojnë anulimin e kërkuar të regjistrimit të licencës; ose
ii. një deklaratë e pavërtetuar e anulimit të licencës, e nënshkruar si nga mbajtësi, edhe nga i licencuari.

5. *[Interesat e garancisë]* Paragrafët 1 deri në 4 do të zbatohen, *mutatis mutandis*, për kërkesat për regjistrim, ndryshimin e regjistrimit dhe anulimin e regjistrimit të një interesi garancie.

RREGULLI 14 DETAJE NË LIDHJE ME KËRKESËN PËR REGJISTRIMIN E NJË NDRYSHIMI NË PRONËSI

1. *[Përmbajtja e kërkesës]* Një palë kontraktuese mund të kërkojë që kërkesa për regjistrimin e një ndryshimi në pronësi sipas nenit 21, të përmbajë disa ose të gjithë treguesit e mëposhtëm:

- i. një tregues që tregon se kërkohet regjistrimi i një ndryshimi në pronësi;
- ii. numrin e regjistrimit të përfshirë nga ndryshimi;
- iii. emrin dhe adresën e mbajtësit;
- iv. emrin dhe adresën e pronarit të ri;
- v. datën e ndryshimit të pronësisë;
- vi. kur pronari i ri është person juridik, natyrën juridike të atij personi juridik dhe shtetin, dhe, kur aplikohet, njësinë territoriale brenda atij shteti, sipas ligjit të të cilit është organizuar personi juridik në fjalë;
- vii. emrin e një shteti të cilit i përket si shtetas pronari i ri, nëse ai/ajo është shtetas i ndonjë shteti, emrin e një shteti në të cilin pronari i ri ka vendbanimin e tij/saj, nëse ka, dhe emrin e një shteti në të cilin pronari i ri ka një ndërmarrje reale dhe efektive industriale ose tregtare, nëse ka;
- viii. kur mbajtësi ka një përfaqësues, emrin dhe adresën e atij përfaqësuesi;
- ix. kur pronari i ri ka një përfaqësues, emrin dhe adresën e atij përfaqësuesi;
- x. kur pronarit të ri i kërkohet të ketë një adresë dorëzimi ose një adresë për korrespondencë, këtë adresë;
- xi. arsyen për ndryshimin e kërkuar.

2. *[Kërkesat për dokumente mbështetëse për regjistrimin e një ndryshimi në pronësi që rezulton nga një kontratë]* Një palë kontraktuese mund të kërkojë që kërkesa për regjistrimin e një ndryshimi në pronësi që rezulton nga një kontratë të shoqërohet, sipas zgjedhjes së palës kërkuuese, me një nga sa vijon:

- i. një kopje të kontratës, e cila mund të kërkohet të vërtetohet nga një noter publik ose ndonjë autoritet tjetër publik kompetent, në përputhje me kontratën origjinale;
- ii. një ekstrakt të kontratës që tregon ndryshimin e pronësisë, i cili mund të kërkohet të vërtetohet nga një noter publik ose ndonjë autoritet tjetër publik kompetent, si një ekstrakt i njehsuar me origjinalin i kontratës;
- iii. një certifikatë transferimi e pavërtetuar, e nënshkruar si nga mbajtësi ashtu edhe nga pronari i ri;

iv. një dokument transferimi i pavërtetuar, i nënshkruar si nga mbajtësi, ashtu edhe nga pronari i ri.

RREGULLI 15

DETAJE NË LIDHJE ME KËRKESËN PËR REGJISTRIMIN E NJË NDRYSHIMI NË EMËR OSE ADRESË

Një palë kontraktuese mund të kërkojë që kërkesa për regjistrimin e një ndryshimi në emër dhe/ose adresë sipas nenit 22, të përmbajë disa ose të gjithë të dhënat e mëposhtme:

- i. emrin dhe adresën e mbajtësit;
- ii. kur mbajtësi ka një përfaqësues, emrin dhe adresën e këtij përfaqësuesi;
- iii. ku mbajtësi ka një adresë për dorëzimin, këtë adresë.

RREGULLI 16

DETAJE NË LIDHJE ME KËRKESËN PËR KORRIGJIMIN E NJË GABIMI

Një palë kontraktuese mund të kërkojë që kërkesa për korrigjimin e një gabimi sipas nenit 23, të përmbajë disa ose të gjithë treguesit e mëposhtëm:

- i. një tregues që tregon se kërkohet një korrigjim i gabimit;
- ii. numrin e aplikimit ose regjistrimit në fjalë;
- iii. gabimin që duhet korrigjuar;
- iv. korrigjimin që duhet bërë;
- v. emrin dhe adresën e palës kërkuese.

RREGULLI 17

FORMULARI MODEL NDËRKOMBËTAR

Byroja Ndërkombëtare do të publikojë Formularët Model Ndërkombëtar të vendosur nga Asambleja sipas nenit 26/2 “ii”.

RREGULLI 18

KËRKESA PËR UNANIMITET SIPAS NENIT 25/3A

Ndryshimi i rregullave të mëposhtme do të kërkojë unanimitet:

- i. Rregulli 2 “viii” dhe “ix”;
- ii. Rregulli 6;
- iii. Rregulli 12/3;
- iv. Rregulli aktual.

REZOLUTA E KONFERENCËS DIPLOMATIKE

PLOTËSUESE E TRAKTATIT TË RIADIT PËR DISENJOT DHE RREGULLORES SIPAS KËTIJ TRAKTATI

REZOLUTA E KONFERENCËS DIPLOMATIKE PLOTËSUESE MBI TRAKTATIN E RIADIT PËR DISENJOT DHE RREGULLORES SIPAS KËTIJ TRAKTATI

1. Në miratimin e Traktatit, Konferenca Diplomatike konfirmoi se fjalët “procedurë para zyrës” në nenin 1 “viii” nuk do të përfshinin procedurat gjyqësore sipas ligjit përkatës.

2. Në miratimin e nenit 16, Konferenca Diplomatike konfirmoi se ishte e dëshirueshme që kur korrigjimi ose shtimi i një kërkesë për prioritet bëhet në përputhje me nenin 16/1, një palë kontraktuese që kërkon prova sipas neni 4/1 “vii” të lejojë që provat të dorëzohen të paktën brenda afatit kohor për dorëzimin e kërkesës të përmendur në rregullin 12/2.

3. Në miratimin e neneve 17, 18 dhe 21, Konferenca Diplomatike konfirmoi se këto dispozita nuk e pengojnë një zyrë që të kërkojë nga palët për një licencë ose, në rastin e nenit 21, mbajtësi ose pronari i ri, të sigurojnë informacion, në përputhje me ligjin përkatës të asaj pale kontraktuese, për t'u përdorur nga një autoritet tjetër, siç janë autoritetet tatimore ose financiare.

4. Në miratimin e neneve 17/4, 18/3 dhe 21/6, Konferenca Diplomatike konfirmoi se këta paragrafë nuk përjashtojnë mundësinë që një palë kontraktuese që ka një sistem të disenjove të lidhura, të kërkojë që një kërkesë kolektive për regjistrimet e lidhura të bëhet në përputhje me ligjin e saj përkatës.

5. Konferenca Diplomatike konfirmoi se asgjë në rregullin 3/2 nuk do të interpretohet si kërkesë për palët kontraktuese që të mbrojnë disenjot e pjesshme.

6. Kur periudhat kohore në Traktat dhe rregullore identifikohen në muaj, një palë kontraktuese mund të konsiderojë, përveç rasteve që lidhen me nenet 7, 26 dhe 30 dhe rregullin 9, një muaj si një periudhë prej 30 ditësh.

[Fundi i dokumentit]



DLT/DC/26
ORIGINAL: ENGLISH
DATE: NOVEMBER 25, 2024

Diplomatic Conference to Conclude and Adopt a Design Law Treaty (DLT)

Riyadh, November 11 to 22, 2024

RIYADH DESIGN LAW TREATY, REGULATIONS UNDER THE RIYADH DESIGN LAW TREATY AND RESOLUTION BY THE DIPLOMATIC CONFERENCE SUPPLEMENTARY TO THE RIYADH DESIGN LAW TREATY AND THE REGULATIONS THEREUNDER

adopted by the Diplomatic Conference on November 22, 2024

RIYADH DESIGN LAW TREATY

RIYADH DESIGN LAW TREATY

LIST OF ARTICLES

Article 1	Abbreviated Expressions
Article 2	General Principles
Article 3	Applications and Industrial Designs to Which This Treaty Applies
Article 4	Application
Article 5	Representatives; Address for Service or Address for Correspondence
Article 6	Filing Date
Article 7	Grace Period for Filing in Case of Disclosure
Article 8	Requirement to File the Application in the Name of the Creator
Article 9	Amendment or Division of Application Including More Than One Industrial Design
Article 10	Publication of the Industrial Design
Article 11	Electronic Industrial Design System
Article 12	Communications
Article 13	Renewal
Article 14	Relief in Respect of Time Limits
Article 15	Reinstatement of Rights After a Finding by the Office of Due Care or Unintentionality
Article 16	Correction or Addition of Priority Claim; Restoration of Priority Right
Article 17	Request for Recording of a License or a Security Interest
Article 18	Request for Amendment or Cancellation of the Recording of a License or a Security Interest
Article 19	Effects of the Non-Recording of a License
Article 20	Indication of the License
Article 21	Request for Recording of a Change in Ownership
Article 22	Changes in Names or Addresses
Article 23	Correction of a Mistake
Article 24	Technical Assistance and Capacity Building
Article 25	Regulations
Article 26	Assembly
Article 27	International Bureau
Article 28	Revision
Article 29	Becoming Party to the Treaty
Article 30	Entry into Force; Effective Date of Ratifications and Accessions
Article 31	Reservations
Article 32	Denunciation of the Treaty
Article 33	Languages of the Treaty; Signature
Article 34	Depositary

Article 1

Abbreviated Expressions

For the purposes of this Treaty, unless expressly stated otherwise:

- (i) “Contracting Party” means any State or intergovernmental organization party to this Treaty;
- (ii) “Office” means the agency of a Contracting Party entrusted with the registration of industrial designs;
- (iii) “registration” means the registration of an industrial design, or the grant of a patent for an industrial design, by an Office;
- (iv) “application” means an application for registration;
- (v) “applicable law” means, where the Contracting Party is a State, the law of that State and, where the Contracting Party is an intergovernmental organization, the legal enactments under which that intergovernmental organization operates;
- (vi) references to “industrial design” shall be construed as references to “industrial designs”, where the application or the registration includes more than one industrial design;
- (vii) references to a “person” shall be construed as references to both a natural person and a legal entity;
- (viii) “procedure before the Office” means any procedure in proceedings before the Office with respect to an application or registration;
- (ix) “communication” means any application, or any request, declaration, document, correspondence or other information, relating to an application or a registration, which is filed with the Office;
- (x) “records of the Office” means the collection of information maintained by the Office, relating to, and including the contents of, applications and registrations, irrespective of the medium in which such information is stored;
